



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L-132

PËR AUTOMJETE

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR AUTOMJETE

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kushteve bazë të pajisjeve dhe instalimeve të cilat duhet ti ketë mjeti, dimensiononi, masa më e madhe e lejuar dhe ngarkesa boshtore e mjetit si edhe kushtet të cilat duhet ti plotësoj mjeti në trafik, kushtet për importim, homologimin e tipit të mjetit, pjesës përbërëse, njësisë së pavarur teknike, kontrollimin teknik të automjeteve, kontrollimi i rregullsisë teknike në rrugë, regjistrimin e automjeteve, automjetet të cilat kanë dalë prej përdorimit si dhe çështjet tjera lidhur me to.

2. Ky ligj është në përputhshmëri me Direktivën e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nr. 2014/45/EC e datës 3 Prill 2014 për kontrollet teknike periodike; 2014/46/EC të datës 3 Prill 2014 për regjistrimin e automjeteve; 2014/47/EC të datës 3 Prill 2014 për kontrollimin e rregullsisë teknike të automjeteve komerciale në rrugë; 2007/46/EC të datës 5 Shtator 2007 për krijimin e një kornize për miratimin e automjeteve dhe rimorkiove të tyre, dhe të sistemeve, komponentëve dhe njësisë të veçanta teknike të destinuara për automjetet të tilla (Direktive Kornize); 2000/53/EC të datës 18 Shtator 2000 për automjetet jashtë përdorimit; 1999/37/EC të datës 29 Prill 1999 për dokumentet e regjistrimit të automjeteve.

3. Në kuadër të fushëveprimit të këtij ligji zbatohet ligji në fuqi për kundërvajtjet përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj të gjitha institucioneve shtetërore, subjekteve juridike dhe pjesëmarrësve në trafikun rrugorë ashtu siç parashihet me këtë ligj.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Mjet** - është një mjet motorik ose rimorkioja e tij;

1.2. **Mjet motorik** - çdo mjet me djegie të brendshme i cili lëvizë në rrugë me fuqi të vet, ka të paktën katër rrota, i kompletuar apo i pa kompletuar me një shpejtësi maksimale që tejkalon 25 km/h;

1.3. **Mjet motorik hibrid** - është një mjet me të paktën dy konvertues energjie të ndryshëm dhe dy sisteme të ndryshme **ruajtje energjie (në mjet)** për qëllimet e lëvizjes së mjetit;

1.4. **Mjet elektrik hibrid** - është një mjet hibrid që, për qëllimet e lëvizjes mekanike, tërheq energji nga të dy burimet në mjet të energjisë/fuqisë së ruajtur si një karburant të konsumueshëm apo një pajisje për ruajtjen e energjisë elektrike/fuqisë, bateri, kondensator, volant/gjenerator.

1.5. **Masa më madhe e lejuar** - është masa të cilën e përcakton prodhuesi i mjetit sipas karakteristikave strukturale të tij;

1.6. **Akt rregullativ** - është specifikimi i veçantë teknik normativë ose rregullorja e UNECE-së, si shtojcë e marrëveshjes së rishikuar të vitit 1958;

1.7. **Homologimi** - është procedura përmes së cilës vërtetohet se mjeti i caktuar përmbushë dispozitat përkatëse administrative dhe standardet përkatëse teknike.

1.8. **Homologimi i tipit** - është procedurë e homologimit përmes së cilës vërtetohet se tipi i mjetit rrugor, sistemi, pjesa rezervë ose njësia e pavarur teknike përmbushë dispozitat përkatëse administrative, si dhe kërkesat teknike sipas këtij ligji;

1.9. **Tipi i mjetit** - është mjeti rrugor i kategorisë së caktuar, i cili nuk dallon të paktën sa u përket karakteristikave thelbësore. Tipi i mjetit rrugor mund të përmbajë variante dhe versione;

1.10. Autoriteti homologues - është Ministria përkatëse për Transport me kompetencën për të gjitha aspektet e homologimit të tipit të mjetit, sistemit, pjesës përbërëse apo njësisë së pavarur teknike, homologimin individual të mjetit, procesin e autorizimit, lëshimin dhe kur është e nevojshme, tërheqjen e certifikatave të homologimit, vepron si pikë kontaktuese për autoritetet miratuese të shteteve të tjera, përcakton shërbimet teknike dhe siguron se prodhuesit përmbushin obligimet e tyre në lidhje me përshtatjen e produkteve, përcakton shërbimin teknik dhe për të siguruar se prodhuesi përmbush obligimet e tij për sa i përket përputhshmërisë së produktit.

1.11. Subjekti i autorizuar për homologia - subjektin e autorizuar nga Ministria përgjegjëse për transport, për të gjitha aspektet e homologimit të tipit të mjetit, sistemit të tij, pjesëve përbërëse, njësisë të tij të veçanta, homologimet e veçanta të automjeteve; konstatimin e përputhshmërisë së mjeteve apo homologimin individual të mjeteve, zbatimin e procedurës së identifikimit dhe vlerësimin e gjendjes teknike të mjetit;

1.12. Homologimi nacional i tipit - është procedura e homologimit të tipit, e përcaktuar me legjislacionin kombëtar me ç'rast validiteti i një homologimi të tillë është i kufizuar në territorin e shtetit që e ka lëshuar atë;

1.13. Homologimi individual - është procedura përmes së cilës subjekti i autorizuar për homologim vërteton se mjeti rrugor i caktuar, unikat ose jo, i përmbushë dispozitat përkatëse administrative si dhe kërkesat përkatëse teknike në bazë të këtij Ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të këtij ligji;

1.14. Homologimi i tipit në disa faza - është procedura përmes së cilës subjekti i autorizuar për homologim vërteton se varësisht nga gjendja e të kompletuarit, mjeti i pakompletuar apo kompletuar i plotëson dispozitat përkatëse si dhe kërkesat teknike siq përcaktohen me këtë ligj dhe dispozitave të nxjerra në bazë të këtij ligji;

1.15. Homologimi i shumëllojshëm i tipit - është procedura e homologimit hap pas hapi të tipit, për të cilën një ose më shumë homologime të sistemit arrihen në fazën përfundimtare të homologimit të tërësishëm të automjetit, pa qenë e nevojshme lëshimi i certifikatave BE-së së homologimit të tipit për këto sisteme;

1.16. Homologimi hap-pas-hapi i tipit - është procedura e homologimit të mjetit e cila konsiston në grumbullimin hap-pas-hapi të tërësisë së certifikatave BE-së për homologimin e tipit, për sistemet, pjesët përbërëse, njësitë e pavarura teknike, dhe e cila çon, në fazën përfundimtare për homologimin e tërësishëm të mjetit;

1.17. Homologimi një-hapësh i tipit - është procedura e cila konsiston në homologimin e tërësishëm të mjetit me anë të një veprimi të vetëm;

1.18. Metoda virtuale e kontrollit - është simulimi kompjuterik duke përfshirë llogaritjet me të cilat dëshmohet nëse mjeti rrugor, sistemi, pjesa përbërëse, ose njësia e pavarur teknike i plotëson kërkesat teknike të aktit rregullativ. Për qëllimet e testimit, metoda virtuale nuk kërkon përdorimin fizik të mjetit, sistemit, pjesës përbërëse ose të njësisë së pavarur teknike;

1.19. **BE - miratimi i tipit** - është procedura me të cilën një shtet anëtar i BE-së verifikon se tipi i mjetit rrugor, sistemi, pjesa përbërëse ose njësia e pavarur teknike i plotëson dispozitat administrative përkatëse dhe kërkesat teknike në bazë të direktivave të BE-së;

1.20 **Certifikata e BE-së - miratimi i tipit** - është dokumenti me të cilin subjekti i autorizuar për miratim i një shteti anëtar të BE-së dëshmon se tipi i mjetit rrugor, sistemi, pjesa rezervë ose njësia e pavarur teknike është miratuar në bazë të direktivave të BE-së;

1.21. **Certifikata e homologimit të tipit** - është dokumenti me të cilin subjekti i autorizuar për homologim dëshmon se tipi i mjetit rrugor, sistemi, pjesa rezervë ose njësia e pavarur teknike është homologuar sipas këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të këtij ligji;

1.22. **Konstatimi i përputhshmërisë së mjeteve** - është homologimi apo homologimi individual i mjeteve;

1.23. **Certifikata e konformitetit** - është dokumenti i lëshuar nga prodhuesi me anë të së cilit vërtetohet se mjeti cili i përket serisë së tipit të homologuar është në konformitet (pajtueshmëri) me aktet normative në kohën e prodhimit të tij;

1.24. **Certifikata e homologimit individual** - është dokumenti përmes së cilit subjekti i autorizuar për homologim zyrtarisht dëshmon se mjeti i caktuar është i homologuar;

1.25. **Prodhuesi** - është personi fizik ose juridik i cili është përgjegjës para subjektit të autorizuar për homologim për të gjitha aspektet e procedurave të homologimit ose autorizimit dhe për të siguruar përshtatjen e produkteve. Personi fizik ose juridik mund të mos jetë direkt i përfshirë në të gjitha fazat e ndërtimit të mjetit, sistemit, pjesës përbërëse ose të njësisë së pavarur teknike, të cilat i nënshtrohen procedurës për homologim.

1.26. **Përfaqësuesi i prodhuesit** - është çdo person fizik ose juridik, të cilin prodhuesi e autorizon ta përfaqësojë para autoritetit për homologim dhe të ndërmarrë veprime në emrin e tij në pajtim me dispozitat e këtij ligji, dhe aty ku përmendet shprehja “prodhues” duhet të nënkuptohet prodhuesi ose përfaqësuesi i tij;

1.27. **Sistemi** - është tersi e pajisjeve të kombinuara për të kryer një ose më shumë funksione specifike në një automjet i cili i nënshtrohet kërkesave të çdo akti normativ;

1.28. **Specifikimi teknik** - është akt që i përcakton kërkesat teknike të cilat duhet t'i plotësojë mjeti rrugor, sistemi, pjesa rezervë ose njësia e pavarur teknike dhe pajisja që të mund të lëshohen në treg, përkatësisht të mund të përdoren, si dhe procedurat me të cilat mund të verifikohet se a janë plotësuar kërkesat;

1.29. **Pjesët origjinale apo pajisja** - pjesët ose pajisja të cilat janë prodhuar sipas specifikacioneve dhe standardeve të siguruar nga prodhuesi për prodhimin e pjesëve apo pajisjeve për montimin e mjetit. Kjo përfshinë pjesët ose pajisjet të cilat janë prodhuar në linjën e prodhimit të njëjtë si këto pjesë ose pajisje. Supozohet, përveç nëse e kundërta është provuar, se pjesët përbëjnë pjesë origjinale në qoftë se prodhuesi i pjesës vërteton që pjesët përputhen me cilësinë e pjesëve përbërëse të përdorura për montimin e mjetit në fjalë dhe janë prodhuar sipas specifikimeve dhe standardeve të prodhuesit të automjeteve;

1.30. **Pjesë përbërëse** - është pajisja e bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara me akt normativ me qëllim që të jetë pjesë e mjetit i cili mund të miratohet në mënyrë të pavarur nëse në mënyrë shprehimore kërkohet nga dispozitat;

1.31. **Njësia e pavarur teknike** - është pajisja e cila i nënshtrohet kërkesave të aktit rregullativ e dedikuar për mjetin, homologimi i të cilit është bërë veçmas, por vetëm në lidhje me një ose më shumë tipe të caktuara të automjetit në rastet kur është e përcaktuar me akte normative;

1.32. **Mjet i vjetër** - mjeti i cili është i regjistruar si objekt muzeor ose është i regjistruar në regjistrin qendror të trashëgimisë kombëtare;

1.33. **Mjet rrugor i pakompletuar** - është çdo mjet rrugor i cili duhet së paku të nënshtrohet edhe një faze të mëtejme të verifikimit e përmbushjes së kërkesave përkatëse teknike;

1.34. **Mjeti rrugor i kompletuar** - është mjeti rrugor, i cili e ka kaluar procesin disa fazash të homologimit të tipit dhe i cili i përmbush kërkesat përkatëse teknike të përcaktuara me këtë Ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të këtij ligji;

1.35. **Mjeti rrugor nga përmbyllja e serisë** - është çdo mjet rrugor i cili është pjese e rezervave, që nuk mund të regjistrohet ose të shitet ose të lëshohet në përdorim për shkak hyrjes në fuqi të kërkesave të reja teknike, për të cilat nuk është bërë homologimi i tipit;

1.36. **Kontrolli teknik** - është kontroll e përcaktuar për të siguruar se automjeti është i sigurt që të përdoret në rrugët publike dhe është në përputhje me karakteristikat e kërkuara dhe të detyrueshme të sigurisë dhe të mjedisit;

1.37. **Certifikata e kontrollit teknike** - është dokument i lëshuar nga subjekti juridik, dhe i cili përmban rezultatet e kontrollit teknike të mjetit;

1.38. **Subjekti juridik për kontroll teknike** - është subjekti juridik i autorizuar për kryerjen e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;

1.39. **Mangësitë** - janë defektet teknike dhe rastet e tjera të mos-përputhjeve të gjetura gjatë kontrollit teknike;

1.40. **Regjistrimi** - është autorizimi administrativ për hyrjen në shërbim në trafikun rrugor të automjetit, duke përfshirë identifikimin e këtij të fundit me një numër të veçantë, që do të njihet si numri i regjistrimit;

1.41. **Pëlqimi për regjistrim** - është dokumenti i cili lëshohet në procedurën për identifikim, ose vlerësim të gjendjes teknike të mjetit rrugor;

1.42. **Bartësi i certifikatës së regjistrimit të automjetit** - është personi juridik ose fizik në emrin e të cilit mjeti është regjistruar;

1.43. **Anulimi i regjistrimit** - është anulimi i autorizimit për automjetin që të përdoret në trafikun rrugor;

1.44. **Pezullimi** - është periudha kohore në të cilën automjeti nuk është i autorizuar që të shfrytëzohet në trafikun rrugor;

1.45. **Kontrollimi teknik në rrugë** - do të thotë inspektim i papritur teknik i rregullsisë së automjetit i cili kryhet nga njësi mobile për kontrollim teknik të automjeteve nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Ministrisë;

1.46. **Njësia mobile e inspektimit** - është sistemi i transportueshëm i pajisjeve testuese të cilat janë të nevojshme për tu kryer inspektimi detajuar në rrugë nga inspektorët kompetent të thirrur për të kryer një inspektim të tillë;

1.47. **Inspektuesi** - është personi i autorizuar nga Ministria në kuadër të kontrollimit teknik mobil për të kryer kontrollin fillestar apo me të detajuar teknike në rrugë;

1.48. **Mjeti jashtë përdorimit** - është mjeti, përveç mjetit muzeor, i cili nuk arrin t'i korrigjojë defektet në një afat 60-ditor—për t'i përmbushur kushtet e rregullsisë teknike, apo vetëdeklarohet si mjet i paaftë për qarkullim në rrugë me rastin e çregjistrimit, apo mbetet i paregjistruar më gjatë se dy (2) vjet;

1.49. **Certifikata e regjistrimit të mjetit** - është dokumenti i cili i përmban të dhënat për mjetin dhe pronarin e mjetit dhe lëshohet nga Ministria e Punëve të Brendshme me rastin e regjistrimit të mjetit;

1.50. **Ministria** – ministria përkatëse për transport.

1.51. **Parandalimi** - masat që synojnë reduktimin e sasisë dhe dëmtimit të mjedisit nga automjetet jashtë përdorimit, materialeve të tyre dhe substancave.

2. Termat të cilat shfrytëzohen në këtë ligj dhe nuk janë të definuar të përkufizimet, kanë definim në ligjet tjera.

KAPITULLI II MJETET

Neni 4 Rregullat e përgjithshme

1. Mjetet në trafikun rrugor duhet të plotësojnë kushtet lidhur me përmasën, dimensionet, masën më të madhe të lejuar, ngarkimin boshtor, si dhe të kenë instalimet dhe pajisjet e parapara, në gjendje të rregullt. Ministria, përcakton rregullat për dimensionet, ngarkesën boshtore, dhe masën më të madhe të lejuar.

2. Mjetet të cilat nuk i plotësojnë kushtet e parapara lidhur me përmasën, dimensionet, me masën më të madhe të lejuar dhe ngarkimin boshtor, mund të marrin pjesë në trafik rrugor publik nëse i plotësojnë kushtet e posaçme të cilat bëjnë të mundshme lëvizjen e sigurt sipas lejes së dhënë nga Komuna për rrugët lokale apo Ministria për rrugë regjionale dhe nacionale në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, varësisht se në territorin e së cilit marrin pjesë në trafik.

3. Punët operative të matjes, kontrollit të ngarkesës boshtore, masës së përgjithshme dhe dimensionet e mjetit në trafik në rrugë e bënë zyrtari i autorizuar për mbikëqyrjen e trafikut në rrugë publike.

4. Dënohet me gjobë njëqind e tridhjetë (130) €, shoferi i cili drejtojnë mjetin i cili nuk i plotëson kushtet e parapara për masën e përgjithshme, dimensionet dhe ngarkimin boshtor të mjetit.

5. Dënohet me gjobë gjashtëqind (600.00) € subjekti juridik ose institucioni në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit vepron personi i lartpërmendur në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 5

Baza e të dhënave për automjete

Ministria e Punëve të Brendshme me akt nënligjor rregullon bazën e të dhënave për automjetet e regjistruara në Republikën e Kosovës.

Neni 6

Autorizimi i policit, inspektorit dhe doganierit

1. Policia, inspektori i transportit dhe doganieri janë të autorizuar të ndalojnë dhe largojnë nga trafiku automjetin nëse dimensionet, masa, ngarkesa boshtore e tij tejkalojnë kufijtë, apo rrezikohet siguria në trafikun rrugor.

2. Lëshimi i serishëm i automjetit në trafik mund të bëhet vetëm pasi që i njëjti të marrë certifikatën nga autoritetet kompetente, me të cilën dëshmohet gjendja e rregullt.

3. Ngarkesa e automjetit të ndaluar mbetet nën përgjegjësinë e transportuesit që e përdor këtë automjet.

Neni 7

Rregullat për instalimet dhe pajisjet në mjet

Ministria, me akt nënligjor përcakton rregullat për instalimet dhe pajisjet të cilat duhet të ketë mjeti kur merr pjesë në trafik në rrugë publike.

KAPITULLI III

KUSHTET PËR LËSHIMIN E MJETEVE NË TREG

Neni 8

Kushtet për lëshimin e mjeteve në treg

1. Mjeti rrugor, sistemi i tijë, pjesa rezervë, njësia e pavarur teknike dhe pajisja mund të lëshohet në treg dhe mund të fillojë të përdoret nëse i plotëson kërkesat teknike dhe zbaton

procedurën e përcaktuar të identifikimit dhe vlerësimit teknik si dhe nëse është regjistruar sipas dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të miratuara në bazë të këtij ligji;

2. Nuk mund të ndalohet, të kufizohet ose pengohet regjistrimi, shitja dhe shfrytëzimi i mjeteve rrugore në trafik, sistemeve, pjesëve rezerve, njësisve të pavarura teknike nga aspekti i konstruksionit dhe funksionimit të tyre të përfshira në këtë ligj, nëse kërkesat e tilla të përcaktuara me këtë ligj janë plotësuar.

Neni 9

Përfshirjet nga homologimi

1. Dispozitat për homologim nuk aplikohen për:

1.1. Mjetet rrugore të projektuara dhe të dedikuara për nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Policisë së Kosovës ose për nevojat e zjarrfikësve;

1.2. Mjetet rrugore të dedikuara për përdorim në kantiere ndërtimi, mihje sipërfaqësore, gurore, limane dhe aeroporte;

1.3. Makinat e punës;

1.4. Mjetet rrugore shpejtësia më e madhe e konstruksionit të së cilave nuk është mbi 6 km/h;

1.5. Mjetet rrugore të dedikuara për rekreacion jashtë rrugëve publike;

1.6. Mopedët;

1.7. Pajisjen e makinave të konstruktura në mënyrë të veçantë për shfrytëzim në pylltari;

1.8. Pajisjen e makinave pyjore, pajisjen e instaluar në shasin e mjetit rrugor për punë bujqësore;

1.9. Mjetet rrugore të cilat importohen përkohësisht që të përdoren në gara, panairë dhe manifestime të tjera të organizuara në Republikën e Kosovës, me ç' rast importimi i përkohshëm i këtyre mjeteve rrugore mund të zgjasë më së shumti tridhjetë (30) ditë;

1.10. Mjetet rrugore të dedikuara për ngasje në trafikun rrugor dhe të cilat nuk regjistrohen;

1.11. Mjetet rrugore të dedikuara ekskluzivisht për gara;

1.12. Prototipat e mjeteve të cilat përdoren në rrugë nën përgjegjësinë e prodhuesit, për të kryer një program të veçantë për kontrollim, me kusht që të jenë planifikuara dhe punuara në mënyrë të veçantë për këtë qëllim.

Neni 10

Procedura për plotësimin e kushteve

1. Plotësimi i kushteve nga neni 8 i këtij ligji, do të përcaktohen nga procedurat e mëposhtme:
 - 1.1. Homologimi i tipit të mjetit rrugor, sistemit, pajisjes rezerve dhe njësisë së pavarur teknike;
 - 1.2. Homologimi i pjesëve dhe pajisjeve jo origjinale për mjete të cilat nuk kanë homologim për tip;
 - 1.3. Homologimi individual i mjeteve sipas kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta;
 - 1.4. Homologimi individual i mjeteve të përpunuara, riparuar apo modifikuara.
 - 1.5. Identifikimin e mjetit;
 - 1.6. Kontrollimi i zakonshëm apo jashtëzakonshëm i mjeteve me kërkesë të veçantë;
 - 1.7. Vlerësimi i gjendjes teknike të mjetit.
2. Procedurën për homologimin e mjetit rrugor e kryejnë subjektet e autorizuar për homologim, nga Ministria.
3. Ministria me akt nënligjor do të përcaktoj kushtet dhe kriteret të cilat duhet t'i përmbushin subjektet e autorizuar për homologim nga paragrafi 2. i këtij neni.

Neni 11

Prodhimet të cilat nuk janë në përputhje me legjislacionin e BE, por janë të prodhuara në pajtim me standardet nacionale

1. Mjetet të cilat nuk janë të punuara në përputhje me legjislacionin e BE-së, miratohen sipas kërkesës me procedurë të veçantë nga komisioni i teknik ekspertëve, kushtet, kriteret dhe procedurat për emërimin e këtij komisioni përcaktohen me akt nënligjorë.
2. Nëse autoriteti për homologim, në bazë të dokumentacionit dhe të dhënave të tjera lidhur me prodhimin vërteton se mjeti i prodhuar nga paragrafi 1. i këtij neni nuk siguron mbrojtjen e interesit publik, do të ndalojë shfrytëzimin e mjetit, ose do të kërkojë heqjen e tij nga tregu.
3. Masat nga paragrafi 2. i këtij neni mund të ndërmerren nga autoriteti për homologim në rast se janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - 3.1. Nëse në bazë të dhënave teknike e shkencore që janë në dispozicion konstatohet se ekzistojnë shkaqe për ndalimin, përkatësisht për tërheqjen e produktit me qëllim të mbrojtjes së interesit publik dhe për këtë arsye masat e ndërmarra garantojnë nivelin e duhur të sigurisë;
 - 3.2. Nëse i është dhënë mundësia importuesit që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit për masat, të bëjë përmirësimin e mangësive;

3.3. Para marrjes së vendimit lidhur me llojin e masës i thekson vërejtjet dhe arsyeton shkaqet për marrjen e masës.

4. Ne procedurën për homologim nga paragrafi 1. të këtij neni mund të merren parasysh kontrollet e bëra nga subjektet e autorizuar ne shtetin tjetër, nëse rezultatet e kontroleve të tilla pranohen nga autoriteti përkatës në vend.

Neni 12 **Devijimet nga kërkesat**

1. Autoriteti për homologim mund të heq dorë nga kërkesat e caktuara dhe të lejoj daljen në treg për:

1.1. Mjetet rrugore pjesët rezerve dhe njësitë e pavarura teknike të cilave janë bërë në seri më të vogla në pajtim me dispozitat e miratuara të këtij ligji;

1.2. Mjetet rrugore nga përmbyllja e serisë;

1.3. Mjetet rrugore që lejohen si të veçanta.

2. Me rastin e devijimeve nga paragrafi 1. të këtij neni, autoriteti për homologim mund të zbatojë edhe kërkesa relevante alternative të rekomanduara nga komisioni i eksperteve.

3. Kërkesa alternative të përmendura në paragrafin 2. të këtij neni janë dispozitat administrative dhe kërkesat teknike, të cilat kanë për qëllim të sigurojnë nivelin më të lartë të mundshëm të sigurisë në rrugë si dhe mbrojtjen e mjedisit.

Neni 13 **Përcaktimi i kushteve për homologim**

1. Ministria përcakton:

1.1. Kushtet teknike për kategori të caktuara të mjeteve rrugore, sistemet e tyre, pjesët përbërëse, njësitë e pavarura teknike dhe pajisjen, dimensionet, masën më të madhe të lejuar dhe ngarkesën boshtore, si dhe kërkesat teknike për mjetet rrugore në pajtim me nenin 8 të këtij ligji;

1.2. Mënyrën dhe procedurën për dhënien e homologimit të tipit dhe të lejes së veçante për mjetet unike rrugore në pajtim me nenin 10 të këtij ligji;

1.3. Formën dhe përmbajtjen e formularit për homologimin e tipit, homologimin e veçantë certifikatën për përshtatje dhe të pëlqimit për regjistrim në pajtim me rregullat e këtij ligji;

1.4. Formën dhe përmbajtjen e shenjave të përshtatjes, si dhe mënyrën e vendosjes së tyre në pajtim me nenin 10 të këtij ligji.

Neni 14

Homologimi i tipit

1. Homologimi i tipit është procedurë e homologimit përmes së cilës vërtetohet nëse tipi i mjetit rrugor, sistemi, njësia e pavarur teknike janë në pajtim me kërkesat teknike përkatëse, dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji.
2. Nëse mjete rrugor prodhohet në faza, homologimi i tipit mund ti jepet për çdo fazë, ndërsa te fazat e mëtejshme merren parasysh homologimet e mëparshme (homologimi shumë fazor) i mjeteve.

Neni 15

Procedura për homologimin e tipit

1. Prodhuesi, përfaqësuesi i prodhuesit apo pronari i mjetit duhet të paraqesë kërkesë të veçantë (ndaras) pranë ndonjërit prej subjekteve të autorizuara për homologim, për çdo tip të mjetit, sistemit, pjesës përbërëse apo njësisë së pavarur teknike, të cilat i nënshtrohen procedurës për homologim.
2. Procedura mbi fazat e tjera të homologimit të tipit, do të rregullohen me një akt nënligjor nga Ministria.
3. Shpenzimet për procedurën e homologimit të tipit, i mbulon prodhuesi/parashtruesi i kërkesës.

Neni 16

Obligimet e subjekteve të autorizuara për homologim

1. Subjektet e autorizuara për homologim, duhet të sigurojnë që prodhuesit të cilët aplikojnë për homologim, ti përmbushin kërkesat teknike dhe procedurën e paraparë me dispozitat e këtij ligji.
2. Subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të miratojnë, të regjistrojnë, apo të lejojnë shfrytëzimin vetëm të atyre mjeteve, sistemeve, pjesëve përbërëse apo njësive të pavarura teknike, të cilat përmbushin kushtet dhe zbatojnë procedure në bazë të këtij ligji.
3. Me rastin e homologimit të tipit të mjetit, subjekti i autorizuar për homologim lëshon certifikatën e homologimit të tipit, përmes së cilës vërtetohet se mjete, pjesa përbërëse apo njësia e pavarur teknike është homologuar.
4. Detyrat e subjekteve të autorizuar për homologim i koordinon dhe mbikëqyrë Ministria.

Neni 17

Vlefshmëria e certifikatës së homologimit të tipit

1. Homologimi i tipi të mjetit mund të jepet vetëm në bazë të procedurës së zbatuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji dhe i cili i plotëson kërkesat e përcaktuara teknike.
2. Certifikata e homologimit të tipit lëshohet për tipin e produktit i cili plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj. Certifikatat e lëshuara janë valide dhe vendosja e produkteve në treg si dhe vënia e përdorimit të produkteve është e vlefshme deri në miratimin e kërkesave për ndryshime apo plotësime të reja. Në dispozitat me të cilat zbatohen kërkesa e reja, plotësuese, të miratuara në bazë të këtij ligji, përcaktohet afati i validitetit të homologimit të tipit e që nuk mund të jete më i shkurtër se gjashtë muaj nga fillimi i validitetit të këtyre dispozitave.
3. Dënohet me gjobë nga tremijë e pesëqind (3.500) € deri pesëmijë (5000) € subjekti i autorizuar që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.
4. Dënohet me gjobë nga pesëqind (500) € deri një mijë (1.000) € personi përgjegjës i subjektit të autorizuar nga paragrafi 3. i këtij neni.

Neni 18

Refuzimi i lëshimit të certifikatës së homologimit për tipin e prodhimit

1. Subjekti i autorizuar për homologim do ta refuzojë lëshimin e certifikatës së homologimit për tipin e prodhimit nëse vërteton se prodhimi, nuk i plotëson kushtet për shfrytëzim, për trafik rrugor, për ambientin jetësor ose për shëndetin e njerëzve, si dhe kushtet tjera teknike të cilat janë duke u zbatuar.
2. Dënohet me gjobë nga tre mijë e pesëqind (3.500) € deri në pesëmijë (5.000) € subjekti i autorizuar që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.
3. Dënohet me gjobë nga pesëqind (500) € deri në një mijë (1.000) € personi përgjegjës pranë institucionit të autorizuar që vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 19

Obligimet e prodhuesit

1. Prodhuesi është përgjegjës të sigurojë përputhshmërinë e prodhimit edhe kur nuk është i përfshirë direkt në të gjitha fazat e ndërtimit të mjetit, sistemit, pjesës përbërëse apo njësisë së pavarur teknike, edhe në rastet kur i modifikon, ndryshon pjesët përbërëse apo sistemet tashmë të miratuara në fazat e mëparshme, e që e dëshmon përmes certifikatës së përputhshmërisë.
2. Kur prodhuesi të cilit i është dhënë homologimi i tipit për mjetin, sistemin, pjesën përbërëse, njësinë e pavarur teknike, në pajtim me dispozitat e këtij ligji obligohet për tërheqjen e serisë së prodhimeve të tipit tashmë të homologuar, kur këto prodhime paraqesin rrezik për sigurinë në rrugë, shëndetin publik dhe mjedisin; obligohet menjëherë ta lajmërojë autoritetin për homologim (homologues) dhe të propozojë përshkrimin e masave për korrigjim.

3. Nëse subjekti i autorizuar për homologim i cili ka dhënë homologimin e tipit është i pakënaqur me masat e ndërmarra nga prodhuesi nga paragrafi 2. i këtij neni, atëherë autoriteti për homologim do të ndërmarrë të gjitha masat mbrojtëse përfshirë edhe tërheqjen e homologimit të tipit të mjetit.

4. Dënohet me gjobë nga një mijë e pesëqind (1.500) € deri në dy mijë (2.000) € prodhuesi – personi juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

5. Dënohet me gjobë nga njëmijë (1.000) € deri në dymijë (2.000) € edhe personi përgjegjës pranë prodhuesit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

6. Dënohet me gjobë nga tremijë e pesëqind (3.500) € deri në pesëmijë (5.000) € subjekti i autorizuar që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

7. Dënohet me gjobë nga pesëqind (500) deri në njëmijë (1.000) € personi përgjegjës pranë subjektit të autorizuar që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 20

Kërkesat plotësuese të subjektit të autorizuar për homologim

1. Subjekti i autorizuar për homologim kërkon nga prodhuesi ndërmarrjen e veprimeve plotësuese, për mënjanimin e mangësive të identifikuara. Nëse prodhuesi dështon në kryerjen e veprimeve të kërkuara brenda afatit kohor të caktuar, në këtë rast njoftohet autoriteti për homologim.

2. Autoriteti për homologim me rastin e njoftimit nga paragrafi 1. këtij neni duhet të ndërmarrë të gjitha masat mbrojtëse përfshirë edhe tërheqjen e homologimit të tipit të mjetit.

3. Dënohet me gjobë nga njëmijë e pesëqind (1.500) deri në dymijë (2.000) € prodhuesi – personi juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

4. Dënohet me gjobë nga pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) € personi përgjegjës pranë prodhuesit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

5. Dënohet me gjobë nga tremijë e pesëqind (3.500) deri në pesëmijë (5.000) € subjekti i autorizuar që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

6. Dënohet me gjobë nga pesëqind (500) deri në njëmijë (1.000) € personi përgjegjës pranë subjektit të autorizuar që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 21

BE miratimi e tipit

Prodhuesi i cili ka BE miratimin e tipit të produktit është përgjegjës që të sigurojë se secili produkt është në përputhje me tipin për të cilin është dhënë miratimi, është i detyruar të organizojë procedurën e prodhimit dhe sistemin për kontrollin e produkteve me qëllim të ruajtjes së cilësisë.

Neni 22

Përputhshmëria e produkteve

1. Prodhuesi i cili ka miratimin e BE për tipin e mjetit është i detyruar që për secilin mjet të prodhuar të jete në përputhje me tipin e miratuar të mjetit që të lëshojë certifikatën e përputhshmërisë.
2. Nëse gjatë prodhimit paraqiten devijime të caktuara, prodhuesi është i detyruar që të ndërmerr të gjitha hapat e duhur për krijimin e serishme të përputhshmërisë së produkteve adekuate me tipin e miratuar të produktit.
3. Në rast të prodhimeve të cilat nuk janë në përputhshmëri, autoriteti për homologim tërheqë homologimin e tipit për produktin ose cakton afatin kohor për mënjanimin e gabimeve të konstatuara. Nëse prodhuesi nuk i bënë veprimet e kërkuara në afatin e caktuar, atëherë autoriteti për homologim tërheqë homologimin e dhënë.
4. Dënohet me gjobë nga tremijë e pesëqind (3.500) deri në katërmijë e pesëqind (4.500) € prodhuesi/subjekti juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.
5. Dënohet me gjobë nga pesëqind (500) deri në njëmijë (1.000) € prodhuesi/personi fizik që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 23

Përshtatja e prodhimit

1. Autoritetit homologues ka të drejtë të kërkojë nga subjekti i autorizuar për lëshimin e BE miratimit të tipit, që të ofrojë dëshmi se ekzistojnë mekanizma dhe procedura të duhura me të cilin sigurohet që produkti i ofruar është në përputhshmëri me tipin e miratuar.
2. Për zbatimin e obligimeve nga paragrafi 1. i këtij neni, subjekti i autorizuar sipas nevojës bashkëpunon me subjektin e autorizuar për miratim nga shteti tjetër.
3. Konstatimin e përputhshmërisë së produktit nga paragrafi 1. i këtij neni e bënë autoriteti për kategoritë C dhe D në pajtim me nenin 32 të këtij ligji.

Neni 24

Ndryshimi i të dhënave dhe homologimi

1. Prodhuesi i cili ka marrë homologimin për tipin në pajtim me dispozitat e këtij ligji është i detyruar që ta informojë autoritetin për homologim në lidhje me të gjitha ndryshimet e të dhënave të përfshira në pakon e informacionit për tipin e homologuar të produktit.
2. Autoriteti për homologim mund të marrë vendim vetëm në lidhje me ato kërkesa ose plotësime të lejimit të tipit të produktit që janë të lidhura me vendimin e tij gjatë homologimit të parë.

3. Secili prodhues, poseduesi homologimit të tipit është i detyruar që ta informoj autoritetin për homologim në lidhje me mbarimin e prodhimit, respektivisht në lidhje me me çdo ndryshim në paketën e informacionit.

4. Dënohet me gjobë nga dymijë e pesëqind (2.500) deri në katërmijë (4.000) € subjekti juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi 1. dhe 3. i këtij neni.

5. Dënohet me gjobë nga pesëqind (500) deri në njëmijë (1.000) € prodhuesi-personi fizik që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

KAPITULLI IV HOMOLOGIMI INDIVIDUAL I MJETEVE

Neni 25 Procedurat

1. Homologimi individual i mjeteve është procedure në të cilën subjekti i autorizuar për homologim në bazë të udhëzimeve të autoritetit për homologim vërteton se mjeteve të veçantë të kontrolluar, unikat ose jo, i plotëson kërkesat e caktuara dhe në pajtim me atë i lëshohet homologimi për mjeteve të veçantë.

2. Certifikata e homologimit nga paragrafi 1. i këtij neni e përmban numrin identifikues të mjetit, prodhuesi, përfaqësuesi i prodhuesit (numrin e shasisë) së cilës i takon.

3. Për dhënien e homologimit individual të mjetit, prodhuesi, përfaqësuesi i prodhuesit, ose pronari është i detyruar që të paraqesë kërkesë në njërin prej subjekteve të autorizuar për homologim.

4. Subjekti i autorizuar për homologim e lëshon certifikatën për përputhshmërisë e mjetit të veçantë të lejuar në bazë të lejes nga paragrafi 1. i këtij neni.

5. Shpenzimet në procedure për lëshimit të certifikatës për homologim individual të mjetit i mbulon prodhuesi/parashtruesi i kërkesës nga paragrafi 3. i këtij neni.

Neni 26 Zbatimi i procedurës

1. Homologimi individual i mjetit realizohet:

1.1. Për mjetin tek i cili tipi nuk ka qenë i homologuar sipas dispozitave të këtij ligji.

1.2. Për mjetin i cili është homologuar individualisht, mirëpo ky homologim është i kufizuar në shtetin i cili e ka realizuar homologimin.

1.3. Mjetet e prodhuara në shumë faza.

Neni 27

Mjetet e përmirësuara dhe të riparuar

1. Procedura e homologimit individual të mjetit të përpunuar realizohet edhe për mjetin tek i cili përputhshmëria me rregulla ka qenë më parë e konstatuar, nëse përpunimet e mëvonshme janë relevante të paktën në një nga kushtet e mëposhtme:

1.1. Kanë të bëjnë me të dhënat e evidentuara në procedurën e regjistrimit të mjeteve;

1.2. Ndikojnë në sistemet e homologuara, pjesët përbërëse, njësitë e veçanta teknike dhe pajisjet e mjeteve;

1.3. Ndikojnë në sigurinë e mjetit, ruajtjen e ambientit nga ndotja.

2. Përmirësimet, respektivisht riparimet nga paragrafi 1 i këtij neni janë punë të cilat kanë të bëjnë me ndryshimet e masës dhe parametrat gjeometrike të mjetit; ndryshimin e tipit, variantin dhe punimin e automjetit; përmirësimin ose ndryshimin e sistemeve të veçanta bazë, respektivisht sistemeve të instaluar paraprakisht, pjesët përbërëse, njësitë teknike të pavarura dhe pajisjet në automjet me karakteristika të ndryshuara; riparimet të rëndësishme ose përmirësime; instalimi i sistemeve jo origjinale dhe të palejuara, pjesët përbërëse, njësitë dhe pajisjet teknike të veçanta; instalimet në punë me gaz të lëngtë nafte, respektivisht me gaz tokësor të kompresuar në mjet.

3. Automjetet e riparuar dhe të përmirësuara verifikohen nga subjekti i autorizuar nga Ministria.

4. Ndërrimi i cilitdo sistemi, pjese përbërëse, njësie të veçantë teknike dhe pajisje të mjeti, me atë origjinal, nuk konsiderohet për ndërrime në mjet.

5. Dënohet me gjobë nga katërmijë (4.000) € subjekti juridik, punëdhënësi i pavarur individual ose individi i cili punon në mënyrë të pavarur e i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, ndërsa personi përgjegjës dënohet në vlerë prej katërqind (400) €, po ashtu dënohet me gjobë prej katërqind (400) € individi i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 28

Kushtet për homologim të individual të mjetit

1. Homologimi individual i mjeteve duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e sjella në bazë të këtij ligji.

2. Dënohet me gjobë nga dymijë (2.000) deri në tremijë (3.000) € subjekti i autorizuar për homologim që jep leje në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

KAPITULLI V

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I GJENDJES TEKNIKE TË AUTOMJETIT

Neni 29 **Procedura**

Identifikimi është procedure ne te cilën konstatohet përputhshmëria e mjetit dhe te dhënat e tija teknike themelore nga dokumentet e ofruara dhe/ose me kontrollin e te dhënave ne regjistrin e te dhënave te mjetit.

Neni 30 **Vlerësimi i gjendjes teknike te automjetit**

1. Vlerësimi i gjendjes teknike te mjetit është procedure gjate te cilës mjeti sipas procedurave të parapara kontrollohet tërësia e mjetit, si dhe përmbushja e kriterëve të sigurisë për pjesëmarrje në trafik.
2. Procedura nga paragrafi 1 i këtij neni, siguron se automjeti është përmirësuar apo riparuar në pajtim me nenin 27 të këtij ligji.

Neni 31 **Mjeti me vlerë muzeore**

Statusi i mjetit me vlerë muzeore i jepet mjetit i cili është më i vjetër se 35 vjet, i cili është i ruajtur dhe teknikisht i mirëmbajtur si dhe i përshtatur me strukturën dhe formën konstruktive origjinale, ndërsa për shkak të rëndësisë së vet historike dhe teknike, nuk përdoret për transportin e përditshëm.

Neni 32 **Autoriteti homologues**

Ministria është autoriteti homologues dhe është përgjegjës për përcjelljen dhe mbikëqyrjen administrative për të gjitha aspektet e homologimit të mjetit, sistemit të tij, pjesëve përbërëse, njësive të tij të veçanta, homologimin e pjesëve, pajisjeve të mjetit si dhe homologimet e veçanta të automjeteve.

Neni 33 **Funksionet e subjekteve për homologim**

1. Subjektet e autorizuara për homologim, i kryejnë punët si vijon:
 - 1.1. analiza, kontrole dhe aktivitetet e certifikimit në lidhje me procedurën për homologimin e tipit të mjetit rrugor;

- 1.2. analiza, kontrole dhe aktivitetet e certifikimit në lidhje me procedurën për homologimin e tipit të sistemit, pjesës përbërëse, njësive të pavarura teknike dhe pajisjes;
 - 1.3. përcaktimin e përmbushjes së kërkesave teknike në procedurën për homologimin e veçantë të mjetit rrugor në përputhje, me kërkesat e përcaktuara me këtë ligj dhe me rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji;
 - 1.4. përcaktimin e përmbushjes të kërkesave teknike në procedurën për homologimin veç e veç të mjetit rrugor në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 30 të këtij ligji;
 - 1.5. homologimin e mjeteve rrugore të riparuar në përputhje me nenin 27 të këtij ligji,
2. Subjekti i autorizuar për homologim i kryen ose i kontrollon analizat e nevojshme për homologimin e tipit, i bën kontrollimet e nevojshme, i zbaton procedurat në përputhje me specifikimet e parapara dhe vepron në përputhje me kërkesat alternative.

Neni 34 **Kushtet funksionale dhe operative**

1. Subjektet e autorizuar për homologim duhet të plotësoj kushtet si në vijim:
 - 1.1. Kushtet hapësinore dhe materialo-teknike që sigurojnë operim në territorin e Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Kuadër përkatës profesional;
 - 1.3. Organizim të punës dhe strukturë organizative që garanton realizim të punëve afatgjata dhe kualitative;
 - 1.4. Përkrahje përkatëse në aspektin teknik dhe të informatikës për kryerjen e punëve;
 - 1.5. Kushte tjera specifike përcaktohen në një akt nënligjorë.
2. Subjekti i cili i plotëson kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni i lëshohen licenca me afat të pakufizuar, me kusht që në mënyrë të pandërprerë i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj dhe dispozitave të nxjerra në bazë të këtij ligji.

Neni 35 **Revokimi i autorizimit**

1. Nëse subjekti i autorizuar për homologim, nuk i kryen aktivitetet e caktuara profesionale në përputhje me rregullat nacionale dhe ndërkombëtare, Ministria do t'ia revokoj autorizimin.
2. Në mënyrë që të kryejnë funksionet e veta, subjektet e autorizuar do të kompensohen nga tarifat e shërbimeve që arkëtohen gjatë kryerjes së punëve;
3. Përcjellja dhe mbikëqyrja ndaj subjekteve të autorizuar për homologim ushtrohet nga Ministria.

4. Ministria përcakton çmimorën për tarifat e parapara. Çmimi është unik dhe vlen për të gjitha subjektet e autorizuara

Neni 36 **Plotësimi i pandërprerë i kushteve**

1. Subjektet e autorizuara për homologim obligohen që në mënyrë të përhershme t'i plotësojnë kushtet për kryerjen e punëve të përcaktuara, në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

2. Dënohet me gjobë nga dhjetë mijë (10.000) € deri në pesëmbëdhjetë mijë (15.000) €, subjekti juridik në rast se detyrat e përcaktuara nuk i kryen profesionalisht apo i kryen në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

3. Dënohet me gjobë nga pesëqind (500) € deri një mijë e pesëqind (1.500) € edhe personi përgjegjës i subjektit juridik.

Neni 37 **Kushtet për revokimin e autorizimit**

1. Ministri me vendim mund t'ia revokojë autorizimin subjektit të autorizuar për homologim nëse:

1.1. ka pushuar që t'i plotësoj kushtet e caktuara për kryerjen e punëve të përcaktuara, në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji;

1.2. kundër tij është ngritur procedura e falimentimit ose likuidimit;

1.3. ka pushuar që të punojë në bazë të vendimit gjyqësor.

Neni 38 **Kushtet për Autorizim**

1. Ministri me akt nënligjor përcakton:

1.1. kushtet e lokalit, pajisjen, aparatet dhe kuadrin profesional për subjektet e autorizuara;

1.2. procedurat për kryerjen e punëve të subjekteve të autorizuara, duke përfshi caktimin e specifikacioneve teknike të detyrueshme të cilat duhet të zbatohen;

1.3. mënyrën dhe procedurën për miratimin dhe revokimin e autorizimit për subjektin e autorizuar.

KAPITULLI VI REGJISTRIMI I MJETEVE

Neni 39

Kushtet për pjesëmarrje në trafik rrugor

1. Në mënyrë që të marrin pjesë në trafik rrugor, mjetet duhet të jenë të regjistruara dhe të posedojnë certifikatë të regjistrimit të mjetit valide ose leje valide për ngasje provuese, të jetë i shënuar me targë regjistrimi ose targa provuese të vendosura për identifikim të mjetit.
2. Përfshimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, rimorkiot e lehta nuk regjistrohen por duhet të posedojnë sistemet dhe pajisjen e përshkruar pa mangësi, duhet të posedojnë targën e identifikimit si dhe duhet të posedoj certifikatën e kontrollit teknik në të cilën është e shënuar data e kontrollës së parë teknike dhe afatin e kontrollës së ardhshme teknike.
3. Në trafikun rrugor nuk mund të marrin pjesë mjetet e paregjistruara si motokultivatori dhe mjetet e punës. Nëse këto mjete marrin pjesë në trafikun rrugor duhet të jenë të regjistruara dhe t'i kenë sistemet dhe pajisjet e përcaktuara teknikisht në rregull.
4. Dënohet me gjobë me njëqind e pesëdhjetë (150.00) euro shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 40

Mjetet e organeve ndërkombëtare

1. Mjetet e misioneve diplomatike dhe konsullore, si dhe mjetet e përdorura nga misionet e huaja, autoritetet ndërkombëtare, zyrat e huaja përfaqësuese në Republikën e Kosovës dhe personalitetet e tyre, bizneset e huaja, subjektet kulturore dhe përfaqësitë tjera me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës mund të qarkullojnë deri në gjashtë (6) muaj nëse janë të regjistruara, si dhe mjetet tjera të cilat janë në qarkullim të lirë ose janë në procedurën e importit të përkohshëm dhe i cili zgjatë më shumë se gjashtë (6) muaj mund të qarkullojnë nëse janë të regjistruara.
2. Ministria e punëve të Brendshme me akt të veçantë nënligjor do të përcaktojë formën e tabelave, kushtet dhe kriteret për regjistrimin a mjeteve të cilat përdoren nga institucionet e huaja siç është përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni.
3. Përfshimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, Ministria e Punëve të Jashtme pas konsultimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me akt nënligjor e përcakton formën e tabelave, kushtet dhe kriteret për regjistrimin e mjeteve të misioneve diplomatike dhe konsullore, si dhe mjetet e përdorura nga misionet e huaja, nga autoritetet ndërkombëtare, nga zyrat e huaja përfaqësuese në Republikën e Kosovës dhe nga personalitetet e tyre.
4. Dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni nuk aplikohen për mjetet e shtetasve të huaj të cilët janë me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës për më tepër se gjashtë (6) muaj, dhe mjetet e të cilëve janë të regjistruara në ndonjë shtet të BE-së.

5. Dënohet me gjobë prej pesëqind (500) € shoferi i cili vepron në kundërshtim me rregullat e këtij neni.

6. Dënohet me gjobë nga pesëmijë (5000) € personi fizik ose juridik i cili vepron në mënyrë të pavarur, i cili vepron në kundërshtim me rregullat e këtij neni, ndërsa personi përgjegjës dënohet në vlerë nga pesë qind (500) €.

Neni 41

Mjetet e regjistruara në shtetet tjera

1. Mjeti i regjistruar në vendin e huaj, në pronësi të shtetasit të huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë, mund të marrë pjesë në trafikun rrugor në Kosovë jo më gjatë se tre (3) muaj nga data e hyrjes në Kosovë.

2. Mjeti i regjistruar në vendin e huaj, në pronësi të qytetarit të Kosovës me qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë Kosovës, mund të marrë pjesë në trafikun rrugor në Kosovë deri në tre (3) muaj nga data e hyrjes në Kosovë dhe i njëjti duhet ta ketë të rregulluar lejen e qëndrimit, të përhershme ose të përkohshme, dhe ta tregojë atë me kërkesën e personit të autorizuar.

3. Mjetin e regjistruar jashtë Kosovës, nga paragrafi 2 i këtij neni, nuk mund ta drejtojë shtetasi kosovar pa prani të pronarit dhe as të autorizohet që i njëjti të qarkullojë me atë mjet në Kosovë. Mjetin e regjistruar në vendin e huaj në pronësi të qytetarit të Kosovës me qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë Kosovës mund ta drejtojë qytetari i Kosovës i cili gjithashtu ka qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në shtetin prej nga vjen automjeti, dhe i cili duhet të posedojë autorizim nga shteti përkatës prej të cilit vjen automjeti.

4. Personi i cili e importon ndonjë mjet nga ndonjë vend jashtë Kosovës, e i cili nuk e ka të rregulluar qëndrimin e përkohshëm ose të përhershëm nga vendi ku është importuar mjeti, të njëjtit i lejohet të marrë pjesë në trafikun rrugor deri në tetë (8) ditë nga data e hyrjes së mjetit në Kosovë.

5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej dyqind (200.00) euro shoferi ose personi i cili e drejton mjetin në trafikun rrugor në kundërshtim me rregullat e paragrafëve 1,2,3 dhe 4 të këtij neni.

6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej dyqind e shtatëdhjetë (270.00) euro shoferi i mjeteve komerciale si: autobusëve, mjeteve të transportit me masën më të madhe se 3500 kg, mjeteve për transportin e materieve të rrezikshme, nëse i njëjti merr pjesë në trafikun rrugor më tepër se tetë (8) ditë nga data e hyrjes së mjetit në Kosovë.

Neni 42

Autorizimet e ministrisë për punë të brendshme

1. Ministria për punë të brendshme përcakton:

1.1. Procedurën për regjistrimin e mjeteve, dhënien dhe validitetin e certifikatës së regjistrimit të mjetit, targat, llojin, përmbajtjen dhe formën e targave të regjistrimit, targave provuese, ndryshimin e të dhënave si dhe çregjistrimin e mjeteve;

1.2. Formën e certifikatës së regjistrimit të mjetit dhe format tjera të cilat përdoren në procedurën e regjistrimit të mjetit;

1.3. Përcaktimi i çmimit për regjistrim të mjeteve si dhe çmimin e targave të regjistrimit dhe atyre provuese, të cilat i paguan pala.

2. Përgjashtimisht nga dispozitat e këtij ligji, Ministria përkatëse e Forcës së Sigurisë e bën regjistrimin e mjeteve të forcës së sigurisë së Kosovës, si dhe për mjetet të cilat përdoren nga shërbimi i sigurisë së Ministrisë përkatëse të Forcës së Sigurisë. Ministria përkatëse e Forcës së Sigurisë përcakton mënyrën e regjistrimit, formën dhe përmbajtjen e targave.

3. Përgjashtimisht nga dispozitat e këtij ligji, Ministria kompetente për Punë të Brendshme përcakton mënyrën e regjistrimit, formën dhe përmbajtjen e targave regjistruese për mjetet e policisë, mjetet e shërbimeve të inteligjencës si dhe mjetet e shërbimit të sigurimit shtetërorë.

4. Përgjashtimisht nga dispozitat e këtij ligji, Ministria përkatëse për Punë të Brendshme përcakton lehtësira për mënyrën e regjistrimit dhe koston e mjeteve motorike hibride dhe elektrike.

5. Me akt të veçantë nënligjor do të përcaktohen kushtet dhe kriteret.

Neni 43

Regjistrimi i mjeteve

1. Regjistrimi i mjeteve nënkupton regjistrimin e të dhënave të mjetit dhe pronarit.

2. Pronari i mjetit nuk mund ta bëjë regjistrimin apo vazhdimin e regjistrimit të mjetit me veprim motorik, as ndërrimin e pronarit, pa e bërë shlyerjen e gjobave për kundërvajtje në trafikun rrugor.

Neni 44

Kushtet e importit të mjeteve rrugore

1. Mjetet rrugore që importohen në Kosovë duhet të kenë:

1.1. Certifikatë të konformitetit për vetura të reja,

1.2. Dëshmi të origjinës dhe pronësisë së mjetit ose pjesëve të veçanta të instaluar;

2. Në Kosovë nuk mund të importohen vetura më të vjetra se dhjetë (10) vjet.
3. Në Kosovë nuk mund të importohen vetura që nuk e plotësojnë standardin Euro katër (4).

Neni 45

Regjistrimi i mjeteve të pronarëve me vendqëndrim në Republikën e Kosovës

Në Republikën e Kosovës regjistrohen mjetet, pronarët e të cilave kanë vendqëndrimin apo selinë në Kosovë, si mjetet diplomatike, përfaqësitë konsullore, misioneve të shteteve të huaja, përfaqësive të organizatave ndërkombëtare në Republikën Kosovë, si dhe përfaqësive ekonomike kulturore të trafikut dhe përfaqësive tjera.

Neni 46

Regjistrimi i mjeteve në pronësi të personave me qëndrim të përkohshëm

1. Në republikën e Kosovës regjistrohen mjetet, pronarët e të cilave janë shtetas të huaj me leje qëndrimi të përkohshme ose të përhershme, , të cilët regjistrojnë automjetet e tyre sipas rregullave doganore apo kërkesave të importit të përkohshëm (automjetet përkohësisht të importuara) dhe përdoren sipas kontratës Leasing, ose kontratës së bashkëpunimit afarist të kontraktuara ndërmjet kompanive me seli në Republikën e Kosovës dhe kompanive tjera me seli në ndonjë shtet tjetër, si dhe automjetet të cilat janë të destinuara për manifestime sportive, ekonomike. Për këto mjete lëshohet certifikata e regjistrimit me afat vlefshmërie prej një (1) viti.
2. Personat me qëndrim të përkohshëm mund t'i regjistrojnë mjetet në pronësi të tyre me targa të përkohshme. Regjistrimi me targa të përkohshme nuk mund të jetë më shkurt se 60 ditë dhe as më gjatë se 12 muaj.
3. Regjistrimin e përkohshëm të automjetit mund ta bëjë edhe personeli i misioneve ndërkombëtare apo i organizatave ndërkombëtare të përcaktuara me ligj.

Neni 47

Certifikata e regjistrimit të automjetit me afat të kufizuar

1. Mjetet regjistrohen edhe kur shtetasi i huaj pas përfundimit të qëndrimit të tij, e transporton mjetin e blerë në Republikën e Kosovës me qëllim që ta regjistroj atë në ndonjë shtet tjetër, ose për mjetet që i nënshtrohen përpunimeve apo përmirësimeve të cilat transportohen jashtë vendit. Certifikata e regjistrimit të automjetit në këtë rast jepet në afat kohor sipas nevojës, varësisht se sa kohë do ti duhet mjetit të arrijë deri në shtetin ku do të regjistrohet. Ky afat kohor i përkohshëm i certifikatës së regjistrimit të automjetit nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë. Në këtë rast mjetet regjistrohen deri në skadim të vlefshmërisë së Certifikatës së regjistrimit të automjetit.
2. Regjistrohen po ashtu edhe mjetet të cilat kanë qenë të regjistruara në Republikën e Kosovës e të cilat janë vjedhur dhe që më vonë janë gjetur; në këtë rast certifikata e regjistrimit të automjetit lëshohet për një periudhë kohore që i nevojitet automjetit për të arritur në Republikën e Kosovës, mirëpo për afat kohor jo më të gjatë se 30 ditë. Mjeti

regjistrohet në afatin kohor deri në skadimin e vlefshmërisë së Certifikatës së regjistrimit të automjetit.

3. Automjetet siç janë të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni pajisen me targa të përkohshme.

Neni 48 **Mjeti në bashkëpronësi**

Nëse mjeti është në pronësi të disa individëve, atëherë regjistrohet në emër të një individi të emëruar nga bashkëpronarët e tij.

Neni 49 **Mjeti me kontratë (leasing)**

Mjeti me kontratë ose me kontratë me qira shitet pa të drejtë pronësie, mund të regjistrohet në emër të përdoruesit, nëse pronari i mjetit e jep pëlqimin me shkrim. Në këtë rast dispozitat ligjore të cilat janë të aplikueshme për pronarin, automatikisht zbatohen edhe për përdoruesin. Në Certifikatën e regjistrimit të automjetit regjistrohet edhe emri i pronarit.

Neni 50 **Mjeti në pronësi të miturit**

Mjeti i cili është në pronësi të fëmijës ose të miturit regjistrohet në emër të njërit prind, kujdestarit, prindit adoptues si dhe bartësit të së drejtës së përdorimit të mjetit. Në këtë rast dispozitat ligjore të cilat vlejnë për pronarin e mjetit zbatohen edhe për përdoruesin. Në Certifikatën e regjistrimit të automjetit regjistrohet edhe emri i pronarit.

Neni 51 **Mjeti në pronësi të personit të rritur që nuk posedon patentë shofer**

Në rastin kur mjeti është në pronësi të personit të rritur i cili nuk posedon patentë shofer, pronari cakton një përdorues të mjetit, dhe në këtë rast dispozitat ligjore të cilat vlejnë për pronarin e mjetit zbatohen edhe për përdoruesin. Në Certifikatën e regjistrimit të automjetit regjistrohet edhe emri i pronarit.

Neni 52 **Përjashtimet**

Dispozitat e nenit 50 dhe 51 të këtij ligji nuk vlejnë për moped dhe motoçikleta, kapaciteti i punës së motorit tek të cilat nuk është më i madh se 125 cm³ dhe fuqia e motorit nuk është më shumë se deri në 11 kw si dhe proporcioni i fuqisë së motorit të mjetit me masën e mjetit nuk tejkalon 0.1 KW/kg; për triçiklet e kategorisë L5e tek të cilat fuqia e motorit nuk e kalon 15 kw të cilat janë në pronësinë e të miturit i cili e posedon patentë shoferin për kategorinë e mjetit në fjalë.

Neni 53

Përdorimi i mjetit

Përdoruesi i mjetit ose bartësi i të drejtës së përdorimit të mjetit mund të jetë vetëm personi i cili posedon patentë shoferin valid për kategorinë e mjetit që përdoret.

Neni 54

Kushtet për regjistrim

1. Mjeti regjistrohet në bazë të kërkesës së pronarit, kërkesës duhet t'i bashkëngjiten:

1.1. Dëshmia e origjinës dhe pronësisë së mjetit ose pjesëve të veçanta të montuara si shtesë;

1.2. Certifikata e konformitetit ose homologimin për regjistrim, në rastin e mjetit për të cilin kërkohet certifikata ose pëlqimi në përputhje me këtë ligj;

1.3. Dëshmia e kompletimit të sigurimit të obligueshëm të përgjegjësisë ndaj paleve të treta për mjetet, ndërsa për mjetet e transportit publik të udhëtarëve kërkohet edhe dëshmia e sigurimit të udhëtarëve;

1.4. Dëshmia e gjendjes së rregullt teknike të mjetit, përveç mjeteve ku kontrollimin teknik nuk e kanë të obliguar. Dëshmia e kontrollit teknik të mjeteve është valide për 30 ditë.

2. Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të regjistrohet mjeti i vjetër muzeor.

Neni 55

Certifikata për regjistrim dhe targat e regjistrimit

1. Për mjetin e regjistruar lëshohet certifikata e regjistrimit dhe targat e regjistrimit, të cilat i lëshon organi kompetent për regjistrimin e mjetit.

2. Përfundimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, për arsye të kryerjes së detyrave për zbulimin e kundërvajtjeve ose veprave penale dhe autorëve të tyre, automjeteve të veçanta të policisë dhe atyre të autoriteteve inteligjente të sigurisë së Republikës së Kosovës, institucioneve të caktuara apo individëve për çështje sigurie mund të lëshohen dy ose më tepër certifikata të regjistrimit dhe komplet targa regjistrimi, nëse kështu e përcakton Ministria kompetente për Punë të Brendshme.

Neni 56

Lëshimi i certifikatës së regjistrimit të mjetit

1. Certifikata e regjistrimit të mjetit, koha e vlefshmërisë, lëshohen dhe ripërtërihen nga autoriteti kompetent i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

2. Për çdo ndryshim të të dhënave në lidhje me regjistrimin e automjeteve, ndryshimet teknike, ndryshimi i pronarit, vendbanimit, duhet që brenda tridhjetë (30) ditëve të njoftohet autoriteti kompetent për regjistrimin e automjeteve.

3. Dënohet me gjobë nga dyqind (200) € pronari i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij nenit.

4. Dënohet me gjobë në vlerë prej njëmijë (1000) € person juridik, i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij nenit.

KAPITULLI VII TARGAT E REGJISTRIMIT

Neni 57 Obligimi i identifikimit

Mjetet në trafikun rrugor duhet të mbajnë dy targa të regjistrimit, përveç motoçikletës, mopedit, katërçikletave të lehta, katërçikletave, triçikletave me motor, mjeteve bashkëngjiteshe, traktorit dhe rimorkios të cilat lejohen të kenë një targë regjistrimi.

Neni 58 Vendosja e targave të regjistrimit

1. Targat e regjistrimit lëshohen për identifikim të mjetit.

2. Dënohet me gjobë pesëqind (500.00) euro shoferi i cili i përdor targat e regjistrimit të mjetit të cilat nuk i takojnë atij mjeti, kurse të njëjtat konfiskohen.

Neni 59 Përmbajtja e targave të regjistrimit

1. Targat e regjistrimit të mjetit nuk mundë të ndryshohen. Nuk lejohet që mjeti në trafikun rrugor të qarkulloj me targa të ndryshme nga ato që është regjistruar nga organin kompetent për regjistrimin e mjetit në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

2. Targat e regjistrimit duhet të jenë të vendosura në vendin e paraparë nga ana e prodhuesit të mjetit ashtu që të shihen dhe të lexohen mirë. Ato duhet të mos jenë të dëmtuara, të shtrembëruara, të mbuluara apo të veshura. Targat regjistruese duhet të përforcohen ashtu që të qëndrojnë në mënyrë permanente në vendin e duhur.

3. Dënohet me gjobë nga gjashtëdhjetë (60) €, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

4. Forma dhe përmbajtja e targave të regjistrimit do të përcaktohet me akt të veçantë nga Ministria përgjegjëse për punë të brendshme.

Neni 60
Ndërrimi i targave të regjistrimit

1. Pronari i mjetit duhet t'i ndërroj targat e regjistrimit me të reja nëse njëra nga targat i ka humbur, dëmtuar, shkatërruar, amortizuar deri në atë masë që bëhet e papërdorshme.
2. Dënohet me gjobë nga njëqind (100) € personi i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 61
Ç'lajmërimi i mjetit

1. Pronari i mjetit të regjistruar mund të ç'lajmëroj mjetin me vetë dëshirë tek organi kompetent për regjistrimin e mjetit në Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe i dorëzon targat e mjetit i cili ç'lajmërohet.
2. Pronari i mjetit të regjistruar duhet ta ç'lajmëroj mjetin te organi kompetent për regjistrimin e mjetit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe ti dorëzoj targat e regjistrimit nëse:
 - 2.1. Mjeti është i shkatërruar;
 - 2.2. Nëse mjeti do të regjistrohet në shtetin tjetër për arsye të shpërnguljes apo ndonjë shkakut tjetër;
 - 2.3. Vlefshmëria e certifikatës për regjistrimin e mjetit i ka skaduar për më tepër se një vit për motoçikleta, moped, katërçikleta të lehta, katërçikletat, triçiklet të lehta, triçikleta, rimorkio banimi ose mjeteve muzeore.
3. Dënohet me gjobë pesëdhjetë (50.00) deri në njëqind e pesëdhjetë (150.00) euro, personi fizik i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 2. të këtij neni.
4. Dënohet me gjobë pesëqind (500.00) euro, personi juridik i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 2. të këtij neni.
5. Dënohet me gjobë dyqind (200.00) euro, personi përgjegjës i personit juridik i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 62
Dorëzimi i targave

Pronari i targave regjistruese të mjetit nuk është i obliguar të dorëzoj targat regjistruese nëse mjeti është dhuruar dhe si i tillë regjistrohet me të njëjtat targa regjistruese dhe në emër të pronari të ri.

Neni 63

Ndërrimi i pronësisë

1. Çlajmërimi i mjetit për shkak të ndërrimit të pronarit është i mundur vetëm nëse në të njëjtën kohë regjistrohet pronari i ri i mjetit në evidencë.
2. Gjatë bartjes së pronësisë, pronari i ri e regjistron mjetin në emër të tij në afatin kohor prej tridhjetë (30) ditësh nga data e blerjes së mjetit.
3. Dënohet me gjobë prej pesëdhjetë (50.00) deri në njëqind e pesëdhjetë (150.00) euro personi i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni.
4. Dënohet me gjobë pesëqind (500.00) euro personi juridik i cili vepron në kundërshtim me këtë nen, ndërsa personi përgjegjës i personit juridik dënohet në vlerë prej njëqind e pesëdhjetë (150.00) eurosh.

Neni 64

Ruajtja e targave të regjistrimit

Organi kompetent për regjistrimin e mjetit në Ministrinë e Punëve të Brendshme i ruan targat e regjistrimit të dorëzuara një vit nga data e dorëzimit. Nëse deri në këtë afat kohor me këto targa regjistrimi nuk është regjistruar i njëjti mjet, atëherë këto targa asgjësohen.

Neni 65

Detyrat e pronarit të mjetit jashtë përdorimit

1. Pronari i mjetit të papërdorshëm sipas rregullave për mbrojtjen e mjedisit duhet të çlajmëroj mjetin dhe të paraqes dëshminë e asgjësimit të tij siç është e përcaktuar me rregullat e mbrojtjes së mjedisit. Këtë të dhënë autoriteti regjistrues e evidenton në regjistrin e mjeteve.
2. Pronari i mjetit i cili nuk është i përdorshëm sipas rregullave për mbrojtjen e mjedisit duhet që pas çlajmërimit të mjetit të japë deklaratë për lokacionin e mjetit, te autoriteti regjistrues i cili e evidenton në regjistrin e mjeteve. Mjeti i evidentuar duhet të qëndroj në lokacionin e cekur në deklaratë, pronari i mjetit duhet që për secilin ndryshim në lidhje me mjetin, të lajmëroj autoritetin regjistrues në afatin kohor prej 30 ditësh.
3. Dënohet me gjobë nga katër dhjetë (40) € individ i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 2. të këtij neni.
4. Dënohet me gjobë pesëqind (500.00) euro personi juridik i cili vepron në kundërshtim me këtë nen ndërsa personi përgjegjës i personit juridik dënohet në vlerë prej njëqind e pesëdhjetë (150.00) eurosh.

KAPITULLI VIII MJETET NË GJENDJE TË RREGULLT TEKNIKE

Neni 66

Mjetet në gjendje të rregullt teknike

Mjeti në trafikun rrugor nuk duhet të ketë të meta/mangësi teknike, duhet ti ketë pajisjet e përcaktuara vepruese dhe sistemet përbërëse pa mangësi funksionale dhe ti plotësoj kërkesat e përcaktuara të sigurisë dhe të mbrojtjes së ambientit.

Neni 67

Mjetet e regjistruar jashtë vendit

Mjetet e regjistruara jashtë vendit mund të qarkullojnë në trafikun rrugor të Republikës së Kosovës nëse janë në gjendjen e duhur teknike, ti kenë specifikat e kërkuara teknike dhe sistemet funksionale të cilat janë të përcaktuara me konventën ndërkombëtare të trafikut rrugor.

Neni 68

Vërtetim i rregullsisë teknike

1. Gjendja e rregullt teknike e mjetit vërtetohet me kontrollimet teknike dhe me inspektim në rrugë kur është pjesëmarrës në trafikun rrugor.
2. Kushtet të cilat duhet ti plotësojnë mjetet për pjesëmarrja në trafik do të përcaktohen me akt të veçantë nënligjor.

Neni 69

Mirëmbajtja, riparimi i mjeteve dhe instalimi (montimi) i pjesëve të homologuara

1. Personat juridik, ose fizik të cilët prodhojnë, riparojnë, përpunojnë, mirëmbajnë, tregtojnë me mjete, sisteme dhe pjesë rezervë të mjeteve ose sisteme të veçanta për mjete duhet që të sigurojnë profesionalizmin e duhur dhe cilësi të punës duke marrë parasysh të gjitha rregulloret të cilat garantojnë sigurinë e mjeteve në trafikun rrugor.
2. Në mjete mund të vendosen vetëm pajisjet e homologuara, nëse për to kërkohet homologimi.
3. Dënohet me gjobë nga katër qind (400) € individ i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni.
4. Dënohet me gjobë nga katër mijë (4000) € personi juridik, i cili vepron në mënyrë të pavarur në kundërshtim me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, ndërsa personi përgjegjës dënohet në vlerë prej katërqind (400) €.

5. Procedurat nga paragrafi 1. i këtij neni do të rregullohet nga Ministria me akt të veçantë nënligjor.

Neni 70 **Mjetet e veçanta të transportit**

1. Mjetet e veçanta të transportit mund të marrin pjesë në trafikun rrugor nëse janë prodhuar, pajisur, shenjëzuar, kontrolluar dhe nëse janë të pajisura me certifikatën valide në përputhshmëri me rregullat ose marrëveshjen ndërkombëtare për transportin rrugor të mallrave të llojeve të veçanta.

2. Dënohet me gjobë nga katërqind (400) € shoferi i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni për pajisje, shenjëzim dhe kontrollim të mjetit.

3. Dënohet me gjobë në vlerë prej katërmijë (4000) € personi juridik, ose fizik i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni, ndërsa personi përgjegjës dënohet në vlerë prej katërqind (400) €.

Neni 71 **Mjeti për transportin grupor të fëmijëve**

1. Mjeti për transportin grupor të fëmijëve duhet përveç kërkesave të përgjithshme për mjete të përcaktuara në këtë ligj dhe legjislacionin që rregullon fushën e transportit, ti plotësoi edhe kërkesat e veçanta teknike me të cilat garantohej siguria e fëmijëve.

2. Dënohet me gjobë nga dyqind e pesëdhjetë (250) € shoferi i cili e përdorë mjetin në kundërshtim me paragrafin 1. të këtij neni.

3. Dënohet me gjobë nga dy mijë (2.000) € personi juridik i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 1. të këtij neni, ndërsa personi përgjegjës dënohet në vlerë prej dyqind e pesëdhjetë (250) €.

Neni 72 **Traktorët të cilët nuk qarkullojnë në trafikun rrugor**

Ministria përcakton rregullat për pjesëmarrje në trafikun rrugor për traktorët që veprojnë në bujqësi dhe pylltari si dhe pjesët dhe pajisjet e obliguara dhe çështjet tjera lidhur me to.

Neni 73 **Kontrollimi teknik i mjeteve**

1. Verifikimi i gjendjes teknike të mjeteve pjesëmarrëse në trafikun rrugor bëhet përmes kontrolleve teknike, procedurë në të cilën subjekti juridik për kontrollim teknik vlerëson të dhënat e mjetit, gjendjen e pjesëve, sistemeve dhe pajisjeve të mjetit dhe plotësimin e kërkesave tjera për mjetin, të përcaktuara me këtë ligj dhe rregullat e lëshuara në bazë të tij.

2. Subjektet e autorizuar për kontrollim teknik me rastin e kontrollimit teknik të mjeteve janë të obliguar të bëjnë evidentimin e kilometrave të kaluara të mjetit-leximin e odometrit.
3. Dënohet me gjobë dy mijë (2.000.00) euro, personi fizik i cili e ndryshon numrin e kilometrave të kaluara të mjetit.
4. Dënohet me gjobë dhjetë mijë (10.000.00) euro personi juridik i cili e ndryshon numrin e kilometrave të kaluara të mjetit.
5. Dënohet me gjobë një mijë (1.000.00) euro personi përgjegjës i personit juridik i cili e ndryshon numrin e kilometrave të kaluara të mjetit.

Neni 74 **Llojet e kontrolleve teknike**

1. Llojet e kontrolleve teknike janë:
 - 1.1. Kontrollimi teknik i jashtëzakonshëm;
 - 1.2. Kontrollimi teknik vjetor dhe,
 - 1.3. Kontrollimi teknik gjashtëmujor

Neni 75 **Kontrollimi teknik i jashtëzakonshëm**

1. Në kontrollim të jashtëzakonshëm dërgohet:
 - 1.1. mjeti pas aksidentit i cili ndikon në sigurinë e pjesëve përbërëse të mjetit, si rrotat, zonat e deformuara, sistemet e airbag, timonin ose frenat;
 - 1.2. mjeti në rastet kur sistemet e sigurisë dhe mjedisit dhe pjesët përbërëse të mjetit janë ndryshuar apo modifikuar;
 - 1.3. mjeti, në rastet kur rrezikohet siguria në rrugë si pasojë e pajisjeve për frenim, drejtim dhe ndriçim.
2. Drejtuesi apo pronari i mjetit i cili urdhërohet ta dërgojë mjetin në kontrollim teknik të jashtëzakonshëm, duhet ta dërgojë mjetin menjëherë dhe t'ia dorëzojë urdhërdhënësit certifikatën e lëshuar nga subjekti i autorizuar për kontroll teknik.
3. Kontrollimi i jashtëzakonshëm nuk ndikon në afatet e realizimit të kontrollimit teknik të rregullt.
4. Nëse në kontroll teknike të jashtëzakonshme mjeti është në gjendje të rregullt teknike, shpenzimet e kontrollit i heqë subjekti në emër të të cilit vepron urdhërdhënësi për kontrollim teknik të jashtëzakonshëm.

5. Nëse konstatohet se në kontroll teknik të jashtëzakonshëm mjete nuk është në gjendje të rregullt teknike, shpenzimet e kontrollit i heq pronari i mjetit.

6. Dënohet me gjobë njëqind e tridhjetë (130.00) euro shoferi i cili pas urdhrat nuk e dërgon mjetin në kontrollim teknik të jashtëzakonshëm.

Neni 76

Kontrollimi teknik vjetor

1. Kontrollimi teknik vjetor realizohet 1 (një) vit pas kontrollimit të parë për:

1.1. Mjetet e transportit, koka tërheqëse dhe mjetet bashkëngjiteshe;

1.2. Mjetet për transportin e materieve të rrezikshme të cilat duhet të jenë në harmonizim me rregullat dhe të shenjëzuara në mënyrë të veçantë;

1.3. Mjetet e punës;

1.4. Autobusë;

1.5. Mjetet bashkëngjiteshe përveç rimorkios së lehtë banimi, rimorkio e traktorit, rimorkio të veçanta për bartjen e barkave, kuajve sportiv, hidro motoçikletave dhe pajisjeve tjera për sport dhe rekreacion tek të cilat masa më e madhe e lejuar e rimorkios e kalon masën 750 kg mirëpo nuk e tejkalon masën 3500 kg;

1.6. Mjetet për transportin e udhëtarëve

1.7. Mjetet për transportin grupor të fëmijëve;

1.8. Mjetet me të cilat aftësohen kandidatët për shoferë;

1.9. Mjetet me qira;

2. Mjetet nga nënparagrafët 1.6, 1.7, 1.8 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni, duhet që në lejen e trafikut të shënohet qëllimi për të cilin janë dedikuar dhe formën e ndërtimit.

3. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni bëjnë automjetet e reja katër vite pas regjistrimit të parë.

4. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni tri vite pas blerjes e rimorkios së lehtë duke llogaritur blerësin e parë.

Neni 77

Kontrollimi teknik gjashtëmuajor

1. Kontrolli teknik bëhet çdo gjashtë (6) muaj për:

1.1. Mjetet të cilat përdoren për transportin e udhëtarëve, kategoria M2, M3;

- 1.2. Mjetet të cilat përdoren për aftësimin e kandidatëve për shoferë (auto shkolla);
 - 1.3. Mjetet të cilat bëjnë transportin grupor të fëmijëve;
 - 1.4. Mjetet e transportit me masë mbi 7.5 t;
 - 1.5. Mjete të cilat transportojnë materie të rrezikshme.
 - 1.6. mjetet TAXI, mjetet me qira, mjetet e ndihmës së shpejtë.
2. Mjetet të cilat përdoren për qëllime të caktuara nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të kenë të shënuar në lejen e trafikut qëllimin për të cilin janë dedikuar dhe formën e ndërtimit.
 3. Dënohet me gjobë njëqind e tridhjetë (130) € shoferi, mjeti i të cilit nuk i është nënshtruar kontrollimit teknik ashtu siç parashihet me dispozitat e këtij neni.
 4. Dënohet me gjobë pesëqind (500.00) euro personi juridik i cili e përdor mjetin në kundërshtim me këtë nen, ndërsa personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë prej njëqind e pesëdhjetë (150.00) eurosh.

Neni 78

Zbatimi i kontrollimit teknik

1. Kontrollimi teknik i mjeteve duhet të bëhet në harmoni me rregulloret valide dhe duke përdorur pajisje matëse pa të meta teknike të përshkruara dhe pajisjet tjera, pajisjet matëse duhet të jenë të miratuara të kontrolluara dhe të certifikuara në përputhshmëri me rregullat metrologjisë dhe të kalibruara siç duhet, nëse për to nuk ekzistojnë rregulla të metrologjisë, atëherë gjatë realizimit të kontrollimit teknik merren në konsideratë edhe udhëzimet për përdorimin e pajisjeve të cilat përdoren për kontrollimin teknik.
2. Kalibrimi i pajisjeve të kontrollit teknik të mjeteve bëhet pas kontrollit të shtatë mijë (7000) mjeteve. Çmimi për kalibrim përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria përkatëse për tregti dhe industri, në bashkëpunim me Ministrinë.
3. Në qoftë se gjatë kontrollimit teknik konstatohet se mjeti është pa të meta teknike atëherë i lëshohet certifikata në të cilën shënohet afati me të cilin mjeti duhet të bëjë kontrollimin teknik të ardhshëm.
4. Dënohet me gjobë nga tetëmijë (8000) € deri në 15.000.00 € subjekti juridik për kontroll teknik i cili gjatë kontrollimit teknik vepron në kundërshtim me këtë nen, ose e lëshon certifikatën e kontrollimit teknik pa qenë prezent mjeti, ndërsa personi përgjegjës dënohet me gjobë në vlerë prej katërqind (400) €.

Neni 79

Vlerësimi i mangësive gjatë kontrollit të rregullt teknik

1. Mangësitë e gjetura gjatë inspektimeve teknike të automjeteve kategorizohen në njëren prej kategorive të mëposhtme:

- 1.1. mangësi të vogla të cilat nuk kanë efekt të rëndësishëm në sigurinë e automjetit ose ndikimit në mjedis, dhe mospërputhjeve të tjera të vogla.
 - 1.2. mangësi të mëdha të cilat mund të dëmtojnë sigurinë e automjetit ose kanë ndikim në mjedis ose vënë përdoruesit e tjerë të rrugës në rrezik, apo edhe mospërputhjes të tjera më të rëndësishme;
 - 1.3. mangësi të rrezikshme që përbëjnë një rrezik të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë rrugore ose që kanë një ndikim në mjedis.
2. Ministria me akt nënligjor përcakton mënyrën e vlerësimit dhe kategorizimin e mangësive tek mjetet të cilat i nënshtrohen kontrollimit të rregullsisë teknike.
 3. Ministria, në konsultim me Ministrinë përkatëse për mjedis, me akt nënligjor përcakton mënyrën e vlerësimit dhe kategorizimin e mangësive të mjetet sipas ndikimit të ndotjes së mjedisit.
 4. Dënohet me gjobë nga pesëqind (500) € subjekti për kontrollim teknik i cili vepron në kundërshtim me pikën 1.1 e paragrafit 1 të këtij neni, ndërsa personi përgjegjës i subjekti juridik për kontrollim teknik dënohet me gjobë nga njëqind (100).
 5. Dënohet me gjobë tre mijë e pesëqind (3.500.00) euro subjekti për kontrollim teknik i cili vepron në kundërshtim me pikën 1.2 e paragrafit 1 të këtij neni, ndërsa personi përgjegjës i subjekti juridik për kontrollim teknik dënohet me gjobë njëqind (100).
 6. Dënohet me gjobë dhjetëmijë (10000.00) € dhe pezullim të licencës për një vit subjekti për kontrollim teknik i cili vepron në kundërshtim me pikën 1.3 e paragrafit 1 të këtij neni, ndërsa personi përgjegjës i subjekti juridik për kontrollim teknik dënohet me gjobë dy mijë (2.000.00) euro.

Neni 80 **Masat për mënjanimin e mangësive**

1. Nëse gjate inspektimit të rregullsisë teknike të mjetit identifikohen mangësitë nga pika 1.1 e paragrafit 1 të nenit 79, atëherë lëshohet certifikata e rregullsisë teknike të mjetit. Personi fizik ose juridik obligohet që të mënjanojë mangësitë e identifikuarat. Dënohet me gjobë njëqind (100.00) euro personi fizik i cili vepron në kundërshtim me këtë paragraf, ndërsa personi juridik dënohet me pesëqind (500.00) euro.
2. Nëse gjate inspektimit të rregullsisë teknike të mjetit identifikohen mangësitë nga pika 1.2 e paragrafit 1 të nenit 79, atëherë mjeti nuk e kalon testin e rregullsisë teknike. Subjekti për kontrollim teknik i cakton afatin për mënjanimin e mangësisë i cili nuk mund të jetë më tepër se 30 ditë.
3. Nëse gjate inspektimit të rregullsisë teknike të mjetit identifikohen mangësitë nga pika 1.3 e paragrafit 1 të nenit 79, atëherë mjeti nuk e kalon testin e rregullsisë teknike dhe i pezullohet e drejta për pjesëmarrje në trafik. Subjekti për kontrollim teknik i cakton afatin për mënjanimin e mangësive i cili nuk mund të jetë më tepër se 30 ditë.

Neni 81

Ndryshimet e identifikuara

1. Nëse gjatë kontrollimit teknik të mjetit janë konstatuar modifikime apo ndryshime në mjet, të dhënat në lejen e trafikut të mjetit dhe në evidencën elektronike nuk përputhen, atëherë certifikata për kontrollimin teknik mund të lëshohet vetëm pas kryerjes së procedurës së homologimit individual të mjetit në përputhje me këtë ligj. Regjistrimi gjegjës i modifikimit apo ndryshimit të përputhshmërisë bëhet në certifikatën e pëlqimit për regjistrim.
2. Dënohet për me gjobë nga tre mijë (3.000.00) euro personi juridik i cili gjatë kontrollimit teknik vepron në kundërshtim me këtë nen, ndërsa personi përgjegjës dënohet me gjobë nga katërqind (400) €.

Neni 82

Ndryshimet të cilat evidentohen

1. Pronari i mjetit është përgjegjës për ndryshimet e kryera në mjet, se a janë bërë sipas homologimit ose sipas homologimit individual dhe nuk bëjnë pjesë në modifikime të mjetit sipas nenit 81 të këtij ligji.
2. Në ndryshimet nga paragrafi një 1. i këtij nenit bëjnë pjesë montimi i sistemeve përbërëse të cilat ndryshojnë nga pjesët të cilat zëvendësohen dhe si të tilla nuk janë të lejuara për montim në tipa të caktuar të mjeteve siç është:
 - 2.1. sistemi për lirim e gazrave;
 - 2.2. sistemet mekanike për bashkëngjitjen e mjeteve - sferat për tërheqje të diametrit 50mm dhe koka për tërheqje.
3. Instalimet nga paragrafi 2. i këtij nenit nuk bëjnë pjesë në modifikime nëse këto i realizon prodhuesi i këtyre pjesëve, personi juridik ose fizik të cilët janë të regjistruar për mirëmbajtje dhe riparimin e mjeteve. Realizuesi i këtyre montimeve duhet më pas të lëshojë certifikatë mbi përfundimin e këtyre montimeve.
4. Dënohet me gjobë nga njëqind e pesëdhjetë (150) € individi i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 1. të këtij neni.
5. Dënohet me gjobë në vlerë prej njëmijë (1.000) € personi juridik i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni, ndërsa personi përgjegjës dënohet me gjobë në vlerë prej njëqind e pesëdhjetë (150) €.

Neni 83

Ndryshimet e evidentuara të mjetit transportues

1. Pronari i mjetit transportues është i obliguar të kërkojë që ndryshimet e bëra në mjetin e tij, e të cilat janë bërë me pëlqimin e tij, por nuk përbëjnë riparim sipas nenit 27 të këtij ligji, atëher duhet të evidentohen pranë institucionit të autorizuar, në afat prej 30 ditësh nga dita e ndryshimit të bërë.

2. Ndryshimet në paragrafin 1. të këtij nenin, kanë të bëjnë me instalimin e sistemeve të veçanta, pjesëve përbërëse, njësive të pavarura teknike dhe pajisjes që janë të ndryshme prej sistemeve të instaluara bazike, kurse të njëjtat janë licencuar për tu instaluar në tipin konkret të mjetit transportues, siç janë:

2.1. sisteme për nxjerrjen e gazrave, pajisje për tërheqjen e mjeteve rrugore, masa më e madhe e lejuar e të cilave nuk i kalon 3.500 kg, me përjashtim të traktorëve;

2.2. bashkëngjitësh - rimorkios.

3. Instalimin e sistemeve të veçanta, pjesëve përbërëse, njësive të pavarura teknike dhe pajisjes nga paragrafi 2. të këtij neni, e bën subjekti juridik që është regjistruar për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve transportuese, për të cilën lëshohet vërtetimi pas plotësimit të kushteve të caktuara.

4. Dënohet me gjobë nga dyqind (200) € pronarit të mjetit rrugor i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni.

5. Dënohet me gjobë pesëqind (500.00) euro personi juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 84

Instalimi i pajisjes për motor me gaz

1. Instalimin e pajisjes për motor me gaz të lëngshëm naftë, me gaz tokësor të kompresuar, ose pajisjes tjetër konform dispozitave të këtij ligji, e bëjnë subjektet juridike të autorizuar nga Ministria pas plotësimit të kushteve të përcaktuara me këtë ligj.

2. Autorizimi nga paragrafi 1. i këtij neni, i jepet subjekteve juridike të cilat posedojnë autorizimin nga prodhuesi i instalimeve ose pajisjes që e instalojnë, përmbushin kushtet hapësinore, materialo-teknike, kushtet e sigurisë, si dhe kuadrin profesional për vendosjen e instalimit dhe pajisjes plotësuese të mjetit transportues.

3. Nëse subjekti i autorizuar për instalimin e pajisjes për motor me gaz të lëngshëm naftë, dështon në kryerjen e procedurës në përputhje me ligjin ose e ndërpret përmbushjen e kushteve nga paragrafi 2. i këtij neni, Ministri i ngarkuar për transport me vendim do t'ia pezullojë autorizimin dhe do të përcaktoj afatin prej 30 ditësh për mënjanimin e mangësive të konstatuara.

Neni 85

Revokimi i autorizimit

1. Nëse subjekti i autorizuar nuk i mënjanon mangësitë e konstatuara, Ministri me vendim do t'ia revokojë autorizimin.

2. Vendimi nga paragrafi 1. të këtij neni është i formës së prerë dhe kundër të njëjtit mund të hapet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

Neni 86

Ndryshimet që nuk evidentohen

1. Për ndryshimet e mjetit transportues, që nuk kanë ndikim në sigurinë e trafikut rrugor, përkatësisht mbi mjedisin dhe në mënyrë të drejtë dhe të lehtë mund të bëhen para fillimit të shfrytëzimit të mjeteve transportuese, pronari i mjetit transportuese nuk e ka për obligim që të kërkoj evidentimin e tyre.
2. Ndryshimet nga paragrafi 1. i këtij neni, kanë të bëjnë me instalimin e pajisjes për vendosjen e bagazhit, antenave, elementeve dekorative etj.
3. Ministria e punëve të brendshme me akt nënligjor e rregullon përdorimin dhe lejen e vendosjes së xhamave të errët në mjet, në pajtim me standardet e BE-së.

Neni 87

Organizimi i kontrollimit teknik të mjeteve

1. Procedurat e kontrollimit teknik të mjeteve janë unike për të gjitha subjektet të cilat e ofrojnë shërbimin e kontrollit teknik të mjeteve.
2. Ministria përcakton çmimoren për kontrollim teknik. Çmimi është unik dhe vlen për të gjitha subjektet e autorizuara për kontrollim teknik.

Neni 88

Subjektet juridike për kontroll teknike

1. Funkcionet e kontrolleve teknike mund t'i kryejnë subjektet juridike që kanë marrë licencë nga Ministri.
2. Subjektet për kontrolle teknike mund të licencohen edhe për homologim të mjeteve, sipas kushteve të parapara.
3. Subjektit, i cili i plotëson kushtet nga neni 34 dhe neni 90 i këtij ligji, i lëshohet licencë me afat të pakufizuar, me kusht që në mënyrë të pandërprerë t'i plotësojë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj dhe dispozitat nënligjore të nxjerra në bazë të këtij ligji.
4. Dënohet me gjobë dhjetë mijë (10.000.00) euro subjekti juridik i cili kryen punë pa licencë apo me licencë të pezulluar.
5. Dënohet me gjobë tre mijë (3.000.00) euro subjekti juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 89

Licencimin i subjekteve juridike për kontrollim teknik

1. Subjekti juridik për kontroll teknik, licencohet për kryerjen e njëjës apo më tepër punëve, si vijojnë:

- 1.1. vlerësimin e gjendjes teknike të mjeteve;
 - 1.2. kontrollin e mjeteve me kërkesa të veçanta,
 - 1.3. kontroll teknike të jashtëzakonshme dhe periodike.
2. Nuk mund të licencohet asnjë subjekt i ri apo linjë e re për kontroll teknik nëse mesatarja e numrit të kontrolleve teknike të të gjitha subjekteve për kontroll teknik brenda territorit të një komune nuk ka kaluar katër mijë (4000) kontrolle brenda vitit.
3. Kontrolli teknik i mjeteve mund të bëhet vetëm brenda Komunës ku e ka vendbanimin pronari i mjetit. Nëse brenda Komunës nuk ka subjekte për kontroll teknik, atëherë kontrolli bëhet brenda rajonit ku e ka vendbanimin pronari i mjetit.
4. Licenca për kontroll teknik të mjetit apo për homologim lëshohet së paku për një grup kategorish të mjeteve.
5. Licenca e vlerësimit të gjendjes teknike të mjeteve lëshohet vetëm në kuadër të autorizimit për kontroll teknik të mjeteve apo për homologim.

Neni 90 **Kushtet për marrjen e licencës**

1. Për marrjen e licencës nga neni 89 i këtij ligji, subjekti juridik duhet t'i plotësoj kushtet që kanë të bëjnë me:
- 1.1. Kushtet hapësinore
 - 1.2. kuadrin përkatës profesional,
 - 1.3. pajisjen e nevojshme, aparatet dhe lokalet;
 - 1.4. Përkrahje përkatëse në aspektin teknik dhe të teknologjisë informatikës për kryerjen e punëve;
 - 1.5. Kushte tjera specifike përcaktohen në një akt nënligjorë.

Neni 91 **Plotësimi i përhershëm i kushteve**

Subjekti juridik i licencuar obligohet që në mënyrë të përhershme t'i plotësoj kushtet e përcaktuara me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

Neni 92

Revokimi i licencës së subjektit për kontroll teknik

1. Ministri, subjektit juridik për kontroll teknik me vendim i revokon licencën për kryerjen e kontrollit teknik, nëse:

1.1. ka pushuar t'i plotësoj kushtet e përcaktuara, për kryerjen e punëve të përcaktuara, në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji;

1.2. kundër tij është ngritur procedura e falimentimit apo likuidimit;

1.3. ka pushuar të punoj në bazë të vendimit gjyqësor;

1.4. punët nuk i kryen në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji;

1.5. Autoriteti/subjekti për mbikëqyrje profesionale ka njoftuar ministrinë për mos përmbushjen e kërkesave teknike me rastin e kontrollimit teknik të mjeteve.

2. Mbikëqyrjen profesionale nga nën paragrafi 1.5. i paragrafit 1. të këtij neni e kryen ministria ose subjekti i autorizuar për mbikëqyrje profesionale.

3. Vendimi nga paragrafi 1. i këtij neni është përfundimtar, dhe kundër tij mund të ngritet kontest administrativ, në gjykatën kompetente.

Neni 93

Dhënia e provimit

1. Personat e autorizuar për kryerjen e kontrollimit teknik pranë subjekti juridik duhet të japin provimin profesional për aftësim. Provimi profesional mbahet nga komisioni kompetent i Ministrisë i caktuar me vendim të Ministrit. Kandidati i cili e kalon me sukses testin e fiton të drejtën për ushtrimin e profesionit.

2. Punëtorët profesionalë nga paragrafi 1. i këtij neni, duhet të ju nënshtrihen trajnimeve për përfitimin e njohurive në çdo dy vite nga dita e lëshimit të vërtetimit për provimin e dhënë.

Neni 94

Verifikimi i njohurive

1. Kandidati që nuk e ka dhënë provimin do të dërgohet përsëri për dhënien e provimit, në afat prej 15 ditësh nga data e marrjes së rezultateve të provimit.

2. Në periudhën deri në dhënien e provimit profesional, apo e ka dhënë atë dhe nuk merr pjese në afatin e përcaktuar për trajnime për përfitimin e njohurive kandidati nuk ka të drejtë që të kryejë punë për të cilat nevojitet provimi profesional dhe trajnimet e parapara.

Neni 95
Rregullat për subjektet e kontrollimeve teknike

1. Ministri i ngarkuar për transport, për fushën e kontrollit teknik do të miratoj rregulla, për:
 - 1.1. kriteret më të afërta për kushtet e lokalit, pajisjes, aparateve dhe kuadrove për subjektin juridik për kontrollim teknik, si dhe kalibrimin dhe verifikimin e aparateve dhe pajisjeve, në pajtim me nenin 89 të këtij ligji
 - 1.2. procedurat për kryerjen e punëve të kontrollit teknik,
 - 1.3. mënyrën dhe procedurën për lëshimin dhe revokimin e licencës të subjektit juridik për kontrollim teknik,
 - 1.4. grupet dhe kategoritë e mjeteve, për të cilat lëshohet autorizimi për kontrollim teknik të mjeteve,
 - 1.5. mënyrën dhe procedurën e dhënies së provimit profesional dhe verifikimit të njohurive, formën dhe përmbajtjen e formularit të vërtetimit për provimin e dhënë, mënyrën e punës së komisionit për realizimin e provimit profesional dhe programin për dhënien e provimit profesional, si dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për provimet e realizuara profesionale nga ana e komisionit, në pajtim me nenin 91 dhe 92 të këtij ligji;

Neni 96
Inspektimi

Inspektimin e punës së subjekteve juridike për kontrollim teknik e bëjnë zyrtarët e ministrisë.

Neni 97
Kompetencat e personave zyrtarë

1. Personi zyrtar ka për detyrë:
 - 1.1. Të kontrolloj evidencat në kontroll teknike;
 - 1.2. Ti marr të dhënat personale dhe të dhënat tjera nga të dhënat zyrtare dhe bazat tjera të dhënave të cilat nevojiten për të zbatuar kontrollimin. Këto të dhëna duhet ti open personave të autorizuar pa kompensim material;
 - 1.3. Të siguroj të dhënat dhe të kryej rishikimin e objekteve teknike dhe hapësirës së sigurisë, pajisjeve, formularëve, vulave dhe dokumentacionit tjetër;
 - 1.4. Ti marr falas kopjet e dokumenteve të cilat i nevojiten për të zbatuar rishikimin e inspektimit dhe veprimeve;
 - 1.5. Pezullon licencën me rastin e konstatimit të mangësive;
 - 1.6. Kryen edhe veprime të tjera të cilat janë në përputhje me qëllimet e kontrollit.

Neni 98

Masat e zyrtarit të autorizuar

1. Nëse zyrtari i autorizuar ne bazë të këtij ligji, konstaton që subjekti i kontrollimit teknik të mjeteve, shfrytëzon pajisjet dhe pajimet që nuk janë në rregull, që objekti dhe hapësira nuk i plotësojnë kushtet e parapara, kontrollimet teknike të mjeteve i kryen personi i cili nuk posedon dëshmi trajnimi ose punët që i janë besuar institucionit për kontrollimin teknik të mjeteve nuk kryhen sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara, me vendim do të pezullohet licenca deri në eliminimin e mangësive.
2. Personi i autorizuar i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 1. të këtij neni dhe i njëjti e humb të drejtën e ushtrimit të funksionit të mbikëqyrjes së subjekteve për kontrollim teknik (inspektimin e punës).

Neni 99

Pezullimi dhe revokimi e licencës

1. Nëse subjekti për kontrollim teknik të mjeteve nuk i eliminon mangësitë e konstatuara, në intervalin kohor prej gjashtë muajve prej datës kur i është pezulluar licenca, zyrtari i autorizuar i propozon Ministrin që të bëjë revokimin e licencës për kryerjen e kontrollimit teknik të mjeteve.
2. Kundër këtij vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni, në afatin prej pesëmbdhjetë (15) ditësh, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Ministri. Ankesa shqyrtohet nga komisioni i caktuar nga Ministri brenda pesëmbdhjetë (15) ditësh. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.
3. Pala e pakënaqur me vendimin e marrë nga komisioni i cili e ka shqyrtuar ankesën, ka të drejtë të ushtrojë padi në Gjykatën kompetente.
4. Dënohet me gjobë prej tremijë e pesëqind (3.500.00) deri tetëmijë e pesëqind (8.500.00) €, subjekti i kontrollimit teknik nëse vepron në kundërshtim me rregullat e paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 100

Qasja në informatat e riparimeve dhe mirëmbajtjen e mjeteve

1. Informatat për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve janë të nevojshme për konstatimin e gjendjes së mjeteve, servisimit, rishikimit, rishikimeve të rregullta, riparimeve, ri programimeve dhe ri integrimëve të mjeteve ose konstatimin e gjendjes së mjeteve në largësi përfshirë edhe ndryshimet e mëvonshme dhe plotësimet e informatave duke përfshirë të gjitha të dhënat e nevojshme për montimin e pjesëve dhe pajisjeve të mjeteve.
2. Me kërkesën e pronarit të mjetit subjekti për mbikëqyrjen e subjekteve për kontrollim teknik i lëshon palës vetetimin për kilometrat e kaluara të mjetit.

Neni 101
Kompensimi për qasje

1. Prodhuesi ose përfaqësuesi i prodhuesit duhet në përputhje me specifikime teknike për mjete me kompensim të arsyeshëm të shpenzimeve iu mundëson të gjithë mirëmbajtësve të mjeteve të interesuar të kenë qasje të pakufizuara në informata teknike, diagnostike dhe pajisje, sisteme duke i përfshirë këtu të gjitha programet elektronike (softuer) përkatëse të cilat lejojnë qasje në informata për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve.
2. Dënohet me gjobë në vlerë prej katërmijë (4.000.00) € prodhuesi cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ndërsa personi përgjegjës dënohet me gjobë prej katërqind (400.00) €.

KAPITULLI IX
KONTROLLIMI I RREGULLËSISË TEKNIKE NË RRUGË

Neni 102
Kontrolli teknik mobil

1. Kontrollimin teknik mobil në rrugë e kryen Ministria ose subjektet e autorizuara nga ministria.
2. Ministria me akt nënligjor do të përcaktojë kushtet dhe kriteret të cilat duhet ti plotësojë subjekti për kontrollim teknik mobil.

Neni 103
Zbatueshmëria

1. Kontrollit teknik mobil në rrugë i nënshtrohen mjetet të cilat arrijnë të zhvillojnë shpejtësinë mbi 25 km/h.
 - 1.1. automjetet e projektuara dhe të konstruara kryesisht për transportin e personave dhe valixheve, mjetet e kategorisë M1, M2 dhe M3;
 - 1.2. automjetet e projektuara dhe konstruara për transportin e mallrave kategoria e mjeteve N1, N2 dhe N3;
 - 1.3. rimorkio e dizajnuara dhe të ndërtuar për transportin e mallrave ose personave, si edhe për akomodimin e personave, që kanë masë maksimale që tejkalon 3.5t, kategoritë e automjeteve O3 dhe O4;
 - 1.4. traktorët me rrota të kategorisë T5 përdorimi i të cilave kryesisht zhvillohet në rrugët publike për qëllime komerciale të transportimit rrugor, tek të cilat shpejtësia më e madhe e projektuar tejkalon 40 km/h.
2. Kategoritë e mjeteve sipas këtij neni përcaktohen më akt nënligjor nga Ministria.

Neni 104

Inspektimi i mjeteve në rrugë

1. Përzgjedhja e automjetit për kontrollimin e rregullsisë teknike në rrugë si dhe gjatë kryerjes kontrollimi, zyrtarët e autorizuar dhe inspektuesit duhet të përmbahen nga çfarëdo diskriminimi.
2. Kompensimi për angazhimin e njësisë mobile nuk është i lidhur drejtpërdrejt me rezultatet fillestare apo të detajuara të kontrollit të rregullsisë teknike të mjetit.
3. Inspektimet e detajuara të rregullsisë teknike në rrugë duhet të kryhen nga inspektuesit të cilët i plotësojnë kërkesat minimale të kompetencës dhe trajnimeve të përcaktuara me akt nënligjorë nga Ministria.

Neni 105

Përzgjedhja e automjeteve për kontrollim teknik fillestar në rrugë

1. Me rastin e përcaktimit të automjetit i cili do të nënshtrohet kontrollimit teknik fillestar në rrugë, zyrtarët e autorizuar mund të zgjedhin, si prioritet, automjetet që operojnë nga subjektet të cilat për fushëveprim e kanë operimin me rrezik të lartë. Automjetet gjithashtu mund të përzgjedhjen në mënyrë të rastësishme për inspektim, apo kur ekziston dyshimi se automjeti paraqet një rrezik për sigurinë rrugore ose për mjedisin.
2. Ministria me një akt të veçantë do të përcaktojë procedurat për kontrollimin teknik fillestar në rrugë.

Neni 106

Përmbajtja dhe metodat e inspektimeve teknike në rrugë

1. Ministria duhet të sigurojë që automjetet e përzgjedhura në pajtim me nenin 103 të këtij ligji i nënshtrohen inspektimit teknik fillestar në rrugë.
2. Në çdo inspektim teknik fillestar të automjetit, inspektuesi:
 - 2.1. duhet të kontrollojë certifikatën e fundit të rregullsisë teknike dhe raportin e inspektimit teknik në rrugë, të cilat duhet të jenë në dispozicion e të mbahen në automjet;
 - 2.2. duhet të kryej vlerësimin vizual të gjendjes teknike të automjetit;
 - 2.3. bënë një vlerësim vizual të sigurimit të ngarkesës së automjetit,
 - 2.4. mund të kryej kontrole teknike me cilëndo metodë që konsiderohet e përshtatshme. Kontrollat e tilla teknike mund të kryhen në mënyrë që të arsyetohet vendimi për të paraqitur automjetin për një inspektim më të detajuar të rregullsisë teknike në rrugë, ose të kërkojë që mangësitë të korrigjohen menjëherë në rast se një gjë e tillë është e mundur.
3. Inspektuesi duhet të verifikojë nëse ndonjëra nga mangësitë e paraqitura në raportin paraprak të inspektimit teknik në rrugë është korrigjuar.

4. Në bazë të rezultatit të inspektimit fillestar, inspektuesi duhet të vendosë nëse automjeti ose rimorkio i tij duhet ti nënshtrohet një inspektimi më detajuar në rrugë.

Neni 107 **Inspektim i detajuar teknik**

Inspektim i detajuar teknik në rrugë duhet të mbulojë ato pajisje të listuar të cilat konsiderohen të nevojshme dhe të rëndësishme, duke marrë parasysh në mënyrë të veçantë sigurinë e frenave, gomave, rrotave, shasisë dhe ndikimin e dëmshëm, dhe metodat e rekomanduara të zbatueshme për testimin e atyre mjeteve.

Neni 108 **Përcaktimi i pajisjeve për verifikim dhe kontrollim**

Përmbajtja e listës së pajisjeve të cilat duhet ti nënshtrohen testimit, do të përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria.

Neni 109 **Objektet e inspektimit**

1. Inspektimi i detajuar teknik në rrugë kryhet duke përdorur njësinë mobile të inspektimit e cila rregullohet me akt nënligjorë nga Ministria.
2. Shërbimi i kontrollimit teknik mobil në rrugë kompensohet nga ministria përgjegjëse për transport.

Neni 110 **Njësia mobile për kontrollim teknik të mjeteve**

Njësitet mobile për inspektim rregullsisë teknike në rrugë duhet të posedojnë pajisjet përkatëse për kryerjen e inspektimit detaj të rregullsisë teknike të mjetit, përfshirë pajisjen e nevojshme për vlerësimin e gjendjes së frenave dhe efikasitetin e frenave, sistemin e drejtimit, mbështetjen dhe kontrollin e gazrave të liruara në ambient.

Neni 111 **Certifikata e inspektimit**

Për çdo automjet që do të inspektohet, ofrohet një listë e mangësive të mundshme dhe nivelin e tyre të rrezikshmërisë e cila do të përdoret gjatë inspektimeve teknike në rrugë. Përmbajtja e listës do të përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria.

Neni 112

Vlerësimi i mangësive

1. Mangësitë e gjetura gjatë inspektimeve teknike të automjeteve kategorizohen në njëërën prej kategorive të mëposhtme:

1.1. mangësi të vogla të cilat nuk kanë efekt të rëndësishëm në sigurinë e automjetit ose ndikimit në mjedis, dhe mospërputhjeve të tjera të vogla.

1.2. mangësi të mëdha të cilat mund të dëmtojnë sigurinë e automjetit ose kanë ndikim në mjedis ose vënë përdoruesit e tjerë të rrugës në rrezik, apo edhe mospërputhesh të tjera më të rëndësishme;

1.3. mangësi të rrezikshme që përbëjnë një rrezik të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë rrugore ose që kanë një ndikim në mjedis.

2. Nëse gjatë inspektimit të mjetit në rrugë identifikohen mangësitë nga pika 1.1 e paragrafit 1 të këtij neni, atëherë nuk shqiptohet gjobe, me këtë rast personi fizik ose juridik obligohet që të mënjanojë mangësitë e identifikuar. Dënohet me gjobë njëqind (100.00) euro personi fizik i cili vepron në kundërshtim me këtë paragraf, ndërsa personi juridik dënohet me gjobë pesëqind (500.00) euro.

3. Nëse gjatë inspektimit teknik të mjetit në rrugë identifikohen mangësi nga pika 1.2. e paragrafit 1 të këtij neni, atëherë personi fizik dënohet me gjobë njëqind e pesëdhjetë (150.00) euro, ndërsa personi juridik dënohet me pesëqind (500.00) euro. Me këtë rast mjetit i konfiskohen targat e regjistrimit deri në dorëzimin e dëshmisë mbi mënjanimin e mangësive të identifikuar.

4. Nëse gjatë inspektimit teknik të mjetit në rrugë identifikohen mangësi nga pika 1.3. e paragrafit 1 të këtij neni, atëherë personi fizik dënohet me gjobë dyqind (200.00) euro, ndërsa personi juridik me tetëqind (800.00) euro. Me këtë rast mjetit i konfiskohen targat e regjistrimit dhe largohet nga trafiku deri në dorëzimin e dëshmisë mbi mënjanimin e mangësive të identifikuar.

5. Dënohet me gjobë një mijë (1.000.00) deri në tre mijë (3.000.00) euro personi juridik për kontrollim teknik në rrugë i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 113

Automjeti me më shumë mangësi

1. Automjeti i cili ka më shumë mangësi se grupet e mangësive të lartpërmendura në nenin 112 të këtij ligji, duhet të klasifikohen në grupin që korrespondon me mangësitë më serioze. Automjeti i cili tregon disa mangësi në kuadër të fushave të njëjta të inspektimit siç përcaktohen në fushëveprimin e inspektimit të rregullsisë teknike në rrugë, me akt nënligjorë nga Ministria, mund të klasifikohet në grupin tjetër me mangësitë më serioze nëse konsiderohet se efekti i kombinuar i këtyre mangësive rezulton në një rrezik me të lartë për sigurinë rrugore.

2. Për mangësitë e konstatuara sipas këtij neni, dënohet me gjobë njëqind (100.00) €, shoferi automjeti i të cilit gjatë kontrollimit të rregullsisë teknike në rrugë nuk është në rregull.

3. Për mangësitë e konstatuara sipas këtij neni, dënohet me gjobë gjashtëqind (600.00) €, edhe subjekti juridik ose institucioni publik në pronësi të të cilit është mjeti.

Neni 114

Sistemi i kontrollimit të rregullsisë së mjetit në kontrollimin teknik

1. Ministria me akt nënligjor përcakton sistemin e kontrollimit të rregullsisë së mjetit në kontrollimin teknik të rregullt dhe në rrugë, detyrimet e përgjithshme:

1.1. Klasifikimin e kategorive të automjeteve;

1.2. Sistemin e kontrollimit në rrugë;

1.3. Përqindja e automjeteve të kontrolluara;

1.4. Sistemi i shkallës së rrezikshmërisë;

1.5. Përgjegjësitë;

1.6. Vlerësimi i mangësive;

1.7. Kontrolli i sigurimit të ngarkesës;

1.8. Kompensimi i procedurës në raste të mangësive të mëdha dhe të rrezikshme;

1.9. Tarifat e inspektimit;

1.10. Raporti i inspektimeve dhe baza e të dhënave të inspektimeve të rregullsisë teknike në rrugë.

KAPITULLI X MJETET JASHTË QARKULLIMIT

Neni 115

Mjeti jashtë përdorimit

1. Automjetet të cilat janë jashtë përdorimit duhet të asgjësohen dhe menaxhohen nga subjektet juridike të autorizuara nga Ministria përgjegjëse për ambient.

2. Parandalimi, grumbullimi, përdorimi i serishëm, riciklimi i automjeteve jashtë përdorimit do të përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria përgjegjëse për ambient.

Neni 116 Parandalimi

1. Në parandalimin e mbetjeve të automjeteve jashtë përdorimit duhet që:

1.1. Prodhuesit e automjeteve, në bashkëpunim me prodhuesit e materialeve dhe pajisjeve, të kufizojnë përdorimin e substancave të rrezikshme në automjete dhe të zvogëlojnë ato sa më shumë që të jetë e mundur nga konceptimi i automjetit më tutje, në mënyrë që të parandalohet lirimi i tyre në mjedis, të bëjë riciklimin më të lehtë, dhe të shmangë nevojën për shkatërrimin e mbetjeve të rrezikshme;

1.2. Projektimin dhe prodhimin e mjeteve të reja të cilat marrin në konsideratë të plotë dhe lehtësojnë çmontimin, ripërdorimin dhe rikuperimin, në veçanti riciklimin e automjeteve jashtë përdorimit, komponentët dhe materialet e tyre;

1.3. Prodhuesit e automjeteve, në bashkëpunim me prodhuesit e materialeve dhe pajisjeve, të integrojnë një sasi të lartë të materialit të ricikluar në automjete dhe produkte të tjera, në mënyrë që të zhvillohen tregjet për materiale të riciklueshme;

1.4. Të sigurojnë që materialet dhe pjesët përbërëse të automjeteve të vëna në treg nuk përmbajnë plumb, merkur, kadmium ose krom kromin, përveç në rastet e përcaktuara.

Neni 117 Grumbullimi

Grumbullimin e mjeteve jashtë përdorimit e kryen subjekti juridik i licencuar, i cili ka për detyrë të themelojë sistemet për mbledhjen e të gjitha automjeteve jashtë përdorimit dhe, për aq sa është e mundur teknikisht, mbetjet e pjesëve të përdorura të largohen kur makinat e pasagjerëve janë riparuar, si dhe të sigurojnë vënien në dispozicion të objekteve të grumbullimit brenda territorit të tyre.

Neni 118 Trajtimi

Të gjitha mjetet jashtë përdorimit të ruhen, qoftë edhe përkohësisht, dhe të trajtohen në përputhje me kërkesat e përgjithshme mjedisore, si dhe me kërkesat minimale teknike të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 119 Certifikata e asgjësimit të automjeteve të cilat kanë dalë prej përdorimit

Subjekti juridik i autorizuar duhet të themelojë sistemin sipas së cilit prezantimi i certifikatës së asgjësimit është kusht për çregjistrimin e automjetit jashtë përdorimit. Kjo certifikatë duhet të lëshohet pronarit kur automjeti transferohet në objektin për përpunim, të cilat janë të autorizuar për të lëshuar certifikatën për asgjësim si dhe të njoftojë organin kompetent.

Neni 120

Aktet nënligjore që nxjerrën për automjetet të cilat kanë dalë prej përdorimit

Ministria përkatëse për ambient me një akt nënligjorë do të bëjë transpozimin e direktivës evropiane për automjetet jashtë përdorimit në legjislacionin kombëtar.

KAPITULLI XI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 121

Dispozitat për kundërvajtje

Dispozitat për kundërvajtje dhe masa mbrojtëse sipas këtij ligji nuk paragjykojnë zbatimin e Kodit Penal.

Neni 122

Të hyrat

1. Të hyrat që realizohen nga shqiptimi i gjobave për kundërvajtje sipas këtij ligji do të derdhen sipas ligjeve në fuqi për menaxhimin e financave publike.
2. Procedura lidhur me realizimin e gjobave mandatore të cilat shqiptohen nga Policia e Kosovës bëhen në përputhje me dispozitat e Ligjit për kundërvajtje.
3. Neni 44, hyn në fuqi më 1 janar 2018.

Neni 123

Dispozita kalimtare

Neni 89.2 hyn në fuqi gjashtëdhjetë (60) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 124

Dënimi mandator

Dënimi mandator shqiptohet nga zyrtari i autorizuar i Policisë së Kosovës në vendin e ngjarjes, në përputhje me dispozitat e Ligjit për kundërvajtje.

Neni 125

Aktet nënligjore

Autoritetet kompetente për implementimin e dispozitave të këtij ligji brenda një viti nxjerrin akte nënligjore.

Neni 126
Shfuqizimi i ligjit

Më hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji nr. 02/L-70 për siguri në trafikun rrugor dhe të gjitha udhëzimet administrative që kanë dalë nga ky ligj.

Neni 127
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-132
18 prill 2017

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kadri VESELI